



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 19 (827975)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 15 maj 2026



15 MAJ 1955 – 15 MAJ 2026

Kuçova - Nga Djepi i Aviacionit Luftarak Shqiptar në Bazë Strategjike të NATO-s

» faqe 7



MINISTRI I MBROJTJES ERMAL NUFI PRITI NË TAKIM KOMANDANTIN E JFC NAPLES, ADMIRALIN GEORGE M. WIKOFF

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nuçi, mikpritur në një vizitë zyrtare në Tiranë komandantin e Komandës së Forcës së Përbashkët Aleate në Napoli (Allied Joint Force Command Naples – JFC Naples), admiralin George M. Wikoff, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit strategjik ndërmjet Shqipërisë dhe NATO-s. Gjatë takimit, ministri Nuçi vlerësoi rëndësinë e kësaj vizite, duke theksuar se ajo pasqyron partneritetin e qëndrueshëm dhe besimin reciprok ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe aleatëve të NATO-s...

faqe 3



SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË MAQEDONISË SË VERIUT ZHVILLOI VIZITË ZYRTARE NË SHQIPËRI

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjeneralmajor Sashko Lafchiski, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shqipëri, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ushtarak dhe marrëdhënieve strategjike ndërmjet dy vendeve aleate në NATO. Vizita u fokusua në thellimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe në koordinimin e qëndrimeve mbi zhvillimet aktuale të sigurisë në rajon dhe më gjerë. Gjatë takimeve...

faqe 2



"SHQIPËRIA SOT FLET ME ZËRIN E SAJ NË NATO" NGA PËRVOJA NË SHAPTE TE SFIDAT E SIGURISË MODERNE DHE PERSPEKTIVA EURO-ATLANTIKE

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në më shumë se një dekadë anëtarësim në NATO, Shqipëria ka kaluar nga faza e integritit formal drejt një roli gjithnjë e më aktiv në strukturat vendimmarrëse, operacionale dhe strategjike të Aleancës. Përfaqësimi i vendit tonë në nivelet më të larta të komandimit të NATO-s është tashmë një realitet që dëshmon pjekurinë profesionale të Forcave të Armatosura...

faqe 8

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjeneralmajor Sashko Lafchiski, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shqipëri, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ushtarak dhe marrëdhënieve strategjike ndërmjet dy vendeve aleate në NATO.

Vizita u fokusua në thellimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe në koordinimin e qëndrimeve mbi zhvillimet aktuale të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Gjatë takimeve me drejtuesit e lartë të institucioneve të mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, u zhvilluan bisedime mbi zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes, sfidat e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, si dhe kontributet e përbashkëta në kuadër të Aleancës Veriatlantike.

Palët riafirmuan rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke vlerësuar veçanërisht stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta, shkëmbimin e eksperiencave profesionale dhe rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave të armatosura të dy vendeve.

Takim me ministrin e Mbrojtjes, Ermal Nufi

Në kuadër të vizitës zyrtare, gjeneralmajor Sashko Lafchiski u prit në takim edhe nga ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi.

Gjatë bisedimeve, ministri Nufi theksoi rëndësinë strategjike të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet dy vendeve, veçanërisht në funksion të zhvillimit të Korridorit VIII, i cili u vlerësua si një element kyç për lëvizshmërinë ushtarake, sigurinë rajonale dhe ndërlidhjen strategjike në Ballkanin Perëndimor. Palët vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira fqinjësore ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke nënvizuar se si vende aleate të NATO-s mbeten të përkushtuara ndaj ruajtjes së paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajon dhe në kontinentin evropian. Ministri i Mbrojtjes, duke iu referuar mjedisit kompleks të sigurisë dhe sfidave bashkëkohore, theksoi nevojën për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve, duke riafirmuar se Shqipëria qëndron fuqishëm krahas aleatëve dhe partnerëve të saj strategjikë.

Fokus tek siguria rajonale dhe misionet ndërkombëtare

Gjatë takimeve u diskutua edhe mbi zhvillimet aktuale të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, rëndësinë e koordinimit ndërmjet vendeve aleate dhe sfidat që lidhen me stabilitetin rajonal.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua kontributit të dy vendeve në misionet ndërkombëtare të sigurisë, ku u vlerësua angazhimi aktiv në misionin e Bashkimit Europian EUFOR ALTHEA dhe në misionin e NATO-s, KFOR.

Palët theksuan se misioni i NATO-s në Kosovë mbetet një shtyllë kyçe për ruajtjen e stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit në Kosovë dhe në të gjithë rajonin.

Gjithashtu, u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit në kuadër të iniciativave rajonale të sigurisë, ku Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut vijojnë të bashkëpunojnë ngushtë përmes strukturave dhe nismave të NATO-s, si SEDM/SEE-BRIG dhe nisma SHBA – Karta e Adriatikut (A-5).

Vizitë në Regjimentin e Operacioneve Speciale

Në kuadër të agjendës së vizitës, gjeneralmajor Sashko



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut zhvilloi vizitë zyrtare në Shqipëri



Lafchiski zhvilloi gjithashtu takime me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, SH. T. z. Bajram Begaj, si dhe vizitoi Regjimentin e Operacioneve Speciale.

Gjatë kësaj vizite, delegacioni u njoh nga afër me strukturat, kapacitetet operacionale dhe aktivitetin e njësive elitë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Vizita e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut u vlerësua si një tregues i qartë i marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet dy vendeve dhe i angazhimit të përbashkët për forcimin e sigurisë rajonale, bashkëpunimit ushtarak dhe konsolidimit të rolit të NATO-s në Ballkanin Perëndimor.

Forca Detare zhvilloi stërvitje të përbashkët për sigurinë dhe ndalimin detar

Forca Detare, në bashkëpunim me Forcën Ajrore, Regjimentin e Operacioneve Speciale, Policinë Kufitare dhe të Migracionit, si dhe Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, përfunduan me sukses një stërvitje të përbashkët të fokusuar në testimin e kapaciteteve koordinuese dhe operacionale gjatë misioneve të ndalimit detar dhe zbatimit të ligjshmërisë në hapësirën detare.

Stërvitja kishte si qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet strukturave ushtarake dhe institucioneve ligjzbatuese, si dhe forcimin e aftësive për reagim të koordinuar ndaj situatave operative në mjedisin detar.

Gjatë zhvillimit të saj, strukturat pjesëmarrëse testuan procedurat e bashkëpunimit operacionel, komunikimit dhe koordinimit në kohë reale, në funksion të garantimit të sigurisë detare dhe menaxhimit efektiv të incidenteve në hapësirën ujore të Republikës së Shqipërisë. Në fokus të stërvitjes ishin operacionet e ndalimit detar, kontrollit të mjeteve



lundruese, mbështetjes ajrore dhe ndërhyrjes së specializuar, duke demonstruar nivel të lartë gatishmërie dhe profesionalizmi nga të gjitha strukturat pjesëmarrëse. Përfshirja e Forcës Ajrore, Regjimentit të Operacioneve Speciale, Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare evidentoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në përbashkëtimin e sfidave të sigurisë detare, kontrollit kufitar dhe zbatimit të ligjit në det.

Në përfundim të aktivitetit, u vlerësua se stërvitja konfirmoi nivelin e lartë të bashkërendimit ndërinstitucional, gatishmërisë operacionale dhe angazhimit të përbashkët për garantimin e sigurisë detare dhe mbrojtjen e interesave kombëtare në hapësirën detare shqiptare.

Këto stërvitje përbëjnë një element të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura dhe institucioneve partnere, duke kontribuar në forcimin e sigurisë kombëtare dhe ndërveprueshmërisë ndërinstitucionale.

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi priti në takim komandantin e JFC Naples, admiralin George M. Wikoff

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, mikpriti në një vizitë zyrtare në Tiranë komandantin e Komandës së Forcës së Përbashkët Aleate në Napoli (Allied Joint Force Command Naples – JFC Naples), admiralin George M. Wikoff, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit strategjik ndërmjet Shqipërisë dhe NATO-s.

Gjatë takimit, ministri Nufi vlerësoi rëndësinë e kësaj vizite, duke theksuar se ajo pasqyron partneritetin e qëndrueshëm dhe besimin reciprok ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe aleatëve të NATO-s.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes riafirmoi angazhimin e plotë të Shqipërisë ndaj mbrojtjes kolektive, sigurisë euroatlantike dhe vlerave të përbashkëta demokratike mbi të cilat mbështetet Aleanca.

“Shqipëria mbetet një aleate e përkushtuar e NATO-s dhe vijon të kontribuojë aktivisht në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e ndërkombëtar”, u shpreh ministri Nufi gjatë bisedimeve me admiralin Wikoff.

Ai theksoi gjithashtu rëndësinë strategjike të Komandës së Forcës së Përbashkët në Napoli në garantimin e sigurisë euroatlantike dhe në menaxhimin e sfidave të reja të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Fokus tek modernizimi i Forcave të Armatosura dhe sfidat e sigurisë

Ministri Nufi siguroi komandantin e JFC Naples se modernizimi i vazhdueshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbetet një ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi në NATO.



Gjatë takimit, një vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimeve të fundit geopolitike në Europën Juglindore dhe sfidave të sigurisë me të cilat përballlet rajoni.

Palët ndanë vlerësimin se Ballkani Perëndimor mbetet

i ekspozuar ndaj fushatave të dezinformimit, sulmeve hibride dhe kërcënimeve kibernetike, çka kërkon koordinim të vazhdueshëm, bashkëpunim të ngushtë dhe vigjencë të shtuar ndërmjet vendeve aleate.

Në këtë kuadër, u nënvizua rëndësia e forcimit të kapaciteteve mbrojtëse dhe rritjes së ndërveprueshmërisë së forcave ushtarake të vendeve anëtare të Aleancës.

Vlerësim për rolin e KFOR-it në Kosovë

Një vend të rëndësishëm në bisedimet mes ministrit Nufi dhe admiralit Wikoff zuri edhe situata e sigurisë në Kosovë dhe roli i misionit të NATO-s, KFOR.

Ministri i Mbrojtjes shprehu vlerësim të veçantë për praninë dhe angazhimin e NATO-s në Kosovë, veçanërisht në veri të vendit, duke e konsideruar atë thelbësore për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Ai theksoi se prania e KFOR-it përfaqëson një garanci të rëndësishme sigurie dhe një faktor të besueshëm parandalues për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe rajonit.

Në vijim, ministri Nufi konfirmoi se Shqipëria do të vijojë të kontribuojë aktivisht në misionet ndërkombëtare të NATO-s dhe Bashkimit Europian, përfshirë KFOR dhe EUFOR ALTHEA.

Ai bëri të ditur se vendi ynë do të rrisë për herë të parë kontributin e tij me mjete ajrore, si dhe me kapacitete të specializuara për mbrojtjen ndaj kërcënimeve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN).

Roli i JFC Naples në strukturën e NATO-s

Komanda e Forcës së Përbashkët Aleate në Napoli (JFC Naples) është një nga tre komandat operacionale të NATO-s në kuadër të strukturës së saj komanduese.

Misioni i kësaj komande është planifikimi, përgatitja dhe drejtimi i operacioneve ushtarake për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe integritetit territorial të vendeve anëtare të Aleancës, në zonën e përgjegjësisë së Komandantit Suprem të Forcave Aleate në Europë (SACEUR) dhe më gjerë.

Gjithashtu, JFC Naples luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e krizave, parandalimin e kërcënimeve dhe garantimin e gatishmërisë operacionale të forcave dhe strukturave të NATO-s. Vizita e admiralit George M. Wikoff në Shqipëri konsiderohet një tregues i qartë i bashkëpunimit të ngushtë dhe partneritetit strategjik ndërmjet vendit tonë dhe Aleancës Veriatlantike, në funksion të forcimit të sigurisë rajonale dhe euroatlantike.



Dy ushtarakë shqiptarë triumfojnë në “Best Warrior 2026” në Nju Xhersi

Dy ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nëntetari **Marjus Cauli** dhe ushtari IV **Hambel Peçi**, kanë arritur një sukses të jashtëzakonshëm në garën prestigjioze “Best Warrior 2026”, të zhvilluar nga Garda Kombëtare e Nju Xhersit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në një konkurrencë intensiv katër ditore, pjesëmarrësit u përballën me një sërë sfidash të vështira që testuan përgatitjen fizike, aftësitë taktike, orientimin në terren dhe qëndrueshmërinë mendore e profesionale.

Të dy përfaqësuesit shqiptarë u vlerësuan



maksimalisht, duke u shpallur fitues në kategoritë përkatëse:

- **Nëntetar Marjus Cauli** – “Nënoficeri më i mirë”
- **Ushtar IV Hambel Peçi** – “Ushtari më i mirë”

Gjatë gjithë garës, ata demonstruan nivel të lartë profesionalizmi, disipline dhe përgatitjeje ushtarake, duke



përfaqësuar me dinjitet Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe duke lënë gjurmë pozitive në një nga garat më të rëndësishme të Gardës Kombëtare të SHBA-së.

Ky sukses vlerësohet si një arritje e rëndësishme për Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe një dëshmi e bashkëpunimit të ngushtë dhe ndërveprueshmërisë me aleatët strategjikë në kuadër të NATO-s.

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvilloi aktivitete akademike me personalitete të diplomacisë dhe politikës rajonale

Në kuadër të programit mësimor dhe aktiviteteve akademike të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kursantët dhe stafi akademik vijnë të zhvillojnë veprimtari profesionale me personalitete të diplomacisë, politikës dhe institucioneve rajonale e ndërkombëtare, me fokus çështjet e sigurisë, diplomacisë dhe zhvillimeve strategjike në rajon.



Ardita Sinani, e ftuar nderi në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Në vijim të programit akademik, stafi pedagogjik dhe kursantët e KTHOSH, KKSHP dhe KLO të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë ndoqën me interes ligjëratën e znj. Ardita Sinani, Kryetare e Komunës së Preshevës, e ftuar në cilësinë e mysafires së nderit.

Gjatë ligjëratës, znj. Sinani trajtoi temën: "Situata dhe pozita e shqiptarëve në rajon", duke ndarë me pjesëmarrësit analiza dhe këndvështrime mbi zhvillimet politike, sociale dhe institucionale që lidhen me shqiptarët në Ballkanin Perëndimor.

Ajo u ndal veçanërisht tek sfidat aktuale me të cilat përballen shqiptarët në rajon, rëndësia e ruajtjes së identitetit kombëtar, forcimi i bashkëpunimit rajonal, si dhe roli i faktorëve politikë dhe institucionalë në garantimin e të drejtave dhe stabilitetit të shqiptarëve.

Ligjërata u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi interaktiv, ku kursantët adresuan pyetje dhe diskutuan mbi zhvillimet aktuale rajonale, sfidat e sigurisë dhe perspektivën e bashkëpunimit ndërshtetërisht në rajon.

Ambasadorë të vendeve partnere ligjërojnë mbi sigurinë europiane dhe diplomacinë

Në kuadër të programit mësimor të Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16), pjesëmarrësit ndoqën gjithashtu një cikël leksionesh të zhvilluara nga ambasadorë të vendeve partnere, mbi temat e sigurisë europiane, diplomacisë dhe sfidave të mjedisit strategjik në Europën Juglindore.



E ftuar speciale ishte Shkëlqesia e Saj, znj. Lambirini Komini, Ambasadore e Republikës së Greqisë në Tiranë, e cila mbajti ligjëratën me temë: "Siguria në Europën Juglindore dhe siguria europiane nga perspektiva greke".

Në vijim, Shkëlqesia e Tij, z. Reinout Caspar Vos, Ambasador i Mbretërisë së Holandës në Tiranë, trajtoi temën: "Siguria në Europën Juglindore dhe siguria europiane nga perspektiva e Mbretërisë së Holandës".

Ndërsa Shkëlqesia e Tij, z. Uran Ferizi, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Londër, mbajti leksionin me temë: "Dimensioni njerëzor i fuqisë kombëtare në diplomaci - Si qytetarët dhe diplomatët formësojnë diplomacinë kombëtare". Gjatë leksioneve, ambasadorët ndanë analiza dhe vlerësime mbi zhvillimet aktuale të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare, sfidat e mjedisit strategjik në Europën Juglindore, rolin e NATO-s dhe Bashkimit Europian, si dhe rëndësinë e diplomacisë dhe bashkëpunimit strategjik ndërmjet vendeve aleate.

Diskutimet u fokusuan gjithashtu në dimensionin njerëzor të diplomacisë, ndikimin e qytetarëve dhe institucioneve në ndërtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe rëndësinë e koordinimit politik dhe ushtarak përballë sfidave të reja të sigurisë.



Në përfundim të leksioneve, pjesëmarrësit zhvilluan diskutime dhe adresuan pyetje mbi çështjet e trajtuara, duke reflektuar interesin dhe angazhimin e tyre në analizimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë dhe diplomacisë.

Përmes këtyre aktiviteteve akademike, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë vijon të konsolidojë rolin e tij si një institucion i rëndësishëm në përgatitjen profesionale dhe strategjike të personelit civil dhe ushtarak, në funksion të forcimit të kapaciteteve kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes.



Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve zhvilloi trajnim me ekipin e Gardës Kombëtare të New Jersey-t

Në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore u zhvillua trajnimi "Senior NCO Development Training", në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Trajnimi u drejtua nga efektivi të Gardës Kombëtare të New Jersey-t, ndërsa në të morën pjesë nënoficerë nga të gjitha njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ky aktivitet profesional kishte si qëllim forcimin e kapaciteteve drejtuese dhe profesionale të trupës së nënoficerëve, si një element kyç në funksionimin dhe efektivitetin operacional të Forcave të Armatosura.

Gjatë zhvillimit të trajnimit u trajtuan tema me rëndësi të veçantë për zhvillimin profesional të nënoficerëve, duke u fokusuar në procesin e rekrutimit në Forcat e Armatosura, përzgjedhjen dhe kualifikimin e instruktorëve, marrëdhëniet ndërmjet oficerëve dhe nënoficerëve, si dhe menaxhimin e stresit gjatë operacioneve brenda dhe jashtë territorit të vendit.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me praktikat dhe përvojat më të mira të ushtrisë amerikane në fushën e edukimit dhe zhvillimit të nënoficerëve, si dhe të shkëmbejnë eksperiencën profesionale mbi sfidat e përbashkëta të mjedisit ushtarak bashkëkohor.

Në kuadër të programit, ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-t zhvilloi takime edhe me drejtues të lartë të institucioneve ushtarake shqiptare, ndër ta Komandantin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, si dhe Komandantin e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve,



kolonel Besim Bala.

Gjatë këtyre takimeve u vlerësua rëndësia e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet dy forcave partnere, veçanërisht në drejtim të edukimit ushtarak, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimit të eksperiencave.

Trajnimi "Senior NCO Development Training" përbën një tjetër hap konkret në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA-së, duke kontribuar në modernizimin dhe zhvillimin profesional të trupës së nënoficerëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



NËNA QË JETON BREND A NESH

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka disa fjalë që nuk kanë nevojë për shpjegim. Mjafton t'i dëgjosh dhe diçka lëviz menjëherë brenda teje. Fjala "nënë" është njëra prej tyre. Ajo nuk është thjesht një emër. Është kujtesa e parë emocionale e njeriut. Është zëri që dëgjojmë para se të kuptojmë botën. Është dora që na mban kur rrëzohemi për herë të parë dhe mungesa që na dhemb më gjatë se çdo humbje tjetër.

Çdo vit, Maji rikthehet si një ditë për të nderuar nënën. Rrugët mbushen me lule. Rrjetet sociale me fotografi e dedikime. Dyqanet me dhurata. Por përtej festimeve, kjo ditë duhet të jetë edhe një moment ndalese njerëzore.

Një çast reflektimi për të kuptuar sa shumë nga ajo që jemi lidhet me figurën e nënës. Me dashurinë që morëm prej saj. Me mungesën që na la. Me plagët që trashëguam. Me forcën që na mësoi pa fjalë.

Sepse ka mijëra mënyra për të qenë nënë...

Ka nëna që bëhen strehë në një botë të ashpër. Ka nëna që mbajnë familje të tëra mbi supe pa u ankuar kurrë. Ka nëna që fshehin lotët natën vetëm që fëmijët të mos kenë frikë ditën. Ka nëna që e shndërrojnë varfërinë në dinjitet dhe mungesën në dashuri.

Por ka edhe nëna që janë lodhur nga jeta. Nëna që nuk kanë ditur si të përqafojnë, sepse vetë nuk janë përqaftuar kurrë. Nëna që kanë mbijetuar mes dhimbjesh, heshtjesh dhe sakrificash aq të mëdha, sa ndonjëherë kanë harruar si të tregojnë butësi.

Dhe pikërisht këtu fillon e vërteta më e vështirë njerëzore: jo çdo nënë di të dojë në mënyrën që fëmija ka nevojë.

Shoqëria jonë është mësuar ta shohë nënën si figurë të paprekshme. Si një simbol të shenjtë ku nuk lejohet asnjë pyetje, asnjë reflektim, asnjë dobësi njerëzore. Por nëna, para se të jetë simbol, është njeri. Ka frika. Ka lodhje. Ka plagë të vjetra. Ka zhgënjime që nuk i ka treguar askujt.

Shpesh harrojmë se edhe nënat kanë qenë dikur vajza të vogla që kërkonin dashuri.

Në Shqipëri, figura e nënës ka mbajtur mbi vete historinë e një populli të tërë. Nëna shqiptare ka kaluar luftëra, emigrime, varfëri, humbje, diktaturë, pritje të gjata dhe net pa gjumë. Ka rritur fëmijë ndërsa burrat ishin larg. Ka punuar në heshtje. Ka sakrifikuar ëndrrat e veta që fëmijët të kishin një të ardhme më të mirë.

Por askush nuk pyeti shpesh: Kush e mbështeti nënën? Kush ia dëgjoi lodhjen? Kush ia kuptoi vetminë?

Ndoshta për këtë arsye ka kaq shumë dhimbje të heshtura në marrëdhëniet familjare shqiptare. Breza të tërë janë rritur me dashuri që nuk dinte të shprehej. Me prindër që sakrifikonin gjithçka, por nuk dinin të thoshin "të dua". Me nëna që të ushqenin, të mbronin, por nuk arrinin të të përqafonin emocionalisht.

Dhe megjithatë, edhe ajo dashuri e heshtur mbetet dashuri.

Ka njerëz që kalojnë gjithë jetën duke kërkuar miratimin e nënës. Ka të tjerë që ecin me plagën e fjalëve që ajo tha në zemërim. Ka bij e bija që nuk arritën kurrë ta kuptonin nënën derisa u bënë vetë prindër. Dhe ka nga ata që edhe në moshë të thyer, në momentet më të errëta të jetës, pëshpëritin pa vetëdije: "Nanë...".

Sepse njeriu kthehet gjithmonë tek burimi i parë i dashurisë.

"Ka mijëra mënyra për të qenë nënë", me forcën e rrallë të një pasqyre shpirtërore. Ajo nuk gjykon. Nuk akuzon. Nuk kërkon fajtorë. Vetëm na kujton se marrëdhënia me të është lidhja më e fortë dhe më e ndërlikuar që ekziston në jetën njerëzore.

Ajo mund të jetë strehë. Por edhe stuhi. Mund të jetë dritë. Por edhe mungesë.

Mund të jetë forca që të shpëton. Por edhe heshtja që të lëndon.



Dhe kjo nuk e bën nënën më pak të rëndësishme. Përkundrazi, e bën më reale.

Në kohën moderne, kur bota po bëhet gjithnjë e më e ftohtë emocionalisht, figurës së nënës po i shtohen barrë të reja. Gratë sot punojnë më shumë, lodhen më shumë, përballen me ankth, pasiguri ekonomike dhe vetmi emocionale.

Shoqëria pret prej tyre të jenë perfekte, nëna perfekte, bashkëshorte perfekte, profesioniste perfekte.

Por askush nuk është perfekt.

Dhe ndoshta tragjedia më e madhe e kohës sonë është se njerëzit po humbasin aftësinë për të kuptuar lodhjen emocionale të njëri-tjetrit.

Shumë nëna sot buzëqeshin në publik dhe qajnë në heshtje. Shumë ndihen fajtorë sepse nuk arrijnë të jenë gjithçka që bota kërkon prej tyre. Shumë mbajnë barrë psikologjike që askush nuk e sheh.

Ndërsa fëmijët rriten mes teknologjisë, ekranit dhe mungesës së komunikimit të vërtetë emocional.

Në një botë ku njerëzit flasin më shumë se kurrë, por dëgjojnë më pak se kurrë, kjo është një thirrje për t'u kthyer tek ndjeshmëria njerëzore. Tek përqaftimi. Tek fjalë e butë. Tek prania.

Sepse fëmijët nuk rriten vetëm me ushqim apo shkollë. Ata rriten me ndjenjën se janë të dashur.

Dhe mungesa e kësaj ndjenje krijon boshllëqe që shpesh zgjasin gjithë jetën.

Ka njerëz që bëhen të suksesshëm, por vazhdojnë të ndihen të zbrazët.

Ka të tjerë që kanë gjithçka materialisht, por ende kërkojnë ngrohtësinë që nuk morën në fëmijëri.

Ka njerëz që nuk arrijnë të duan sepse askush nuk ua mësoi dashurinë pa frikë.

Dhe kështu, plagët kalojnë nga një brez tek tjetri.

Por ky cikël mund të ndalet....

Mund të ndalet kur një nënë vendos të mos ia trashëgojë fëmijës frikën që ka trashëguar vetë. Kur një baba mëson të

Në Shqipëri,
figura e
nënës ka

mbajtur mbi vete historinë e një populli të tërë. Nëna shqiptare ka kaluar luftëra, emigrime, varfëri, humbje, diktaturë, pritje të gjata dhe net pa gjumë. Ka rritur fëmijë ndërsa burrat ishin larg. Ka punuar në heshtje. Ka sakrifikuar ëndrrat e veta që fëmijët të kishin një të ardhme më të mirë.

flasë me butësi. Kur një familje zgjedh dialogun në vend të heshtjes. Kur një njeri mëson të falë.

Sepse dashuria nuk është perfeksion. Është përpjekje.

Në fund, secili prej nesh mbart brenda vetes diçka nga nëna e vet. Disa mbajnë zërin e saj. Disa buzëqeshjen. Disa forcën për të mbijetuar. Disa plagët që ende dhembin. Por askush nuk del i pandikuar prej saj.

Edhe kur largohet nga kjo botë, nëna mbetet. Në mënyrën si prekim fëmijët tanë. Në mënyrën si kemi frikë. Në mënyrën si dashurojmë. Në mënyrën si lutemi në heshtje.

Ajo bëhet pjesë e shpirtit tonë.

Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse humbja e nënës është një nga dhimbjet më të mëdha njerëzore. Sepse kur ikën ajo, njeriu nuk humbet vetëm një person. Humb vendin ku ndihej fëmijë.

Ndoshta dhurata më e bukur për nënën nuk është një tufë lulesh. Është koha. Është një telefonatë. Një përqaftim i sigurtë. Një "faleminderit" që nuk është thënë kurrë. Një "më fal" i vonuar. Një përpjekje për ta kuptuar atë jo si simbol, por si njeri.

Sepse një ditë, kur zëri i saj të mos dëgjohej më në shtëpi, do ta kuptojmë se sa shumë prej jetës sonë mbante ai zë. Dhe atëherë, ndoshta shumë vonë, do të kuptojmë se nëna nuk ishte thjesht personi që na rriti.

Ajo ishte vetë ndjenja e shtëpisë.

Prandaj, "Ditën e Nënës", le të mos festojmë vetëm figurën ideale të saj. Le të nderojmë Lodhjen e saj, Heshtjen, Sakrificën, Gabimet, Përpjekjet, Dashurinë që ndonjëherë nuk dinte si të shprehej.

Sepse në fund, secila nënë mbetet brenda nesh: si një lutje, si një mall, si një plagë e heshtur, apo si një dritë që nuk shuhet kurrë.

Dhe ndoshta, e gjithë pjekuria e njeriut fillon në çastin kur ai arrin të kuptojë se edhe nënat kanë pasur nevojë të shpëtoheshin nga dikush.

10 MAJ 1958 - THEMELIMI I AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA, 68 VITE NË SHËRBIM TË KOMBIT, DIJES DHE MBROJTJES

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Nuk ka ushtri moderne pa arsim ushtarak modern”

Historia e arsimit ushtarak shqiptar është historia e vetë përpjekjeve të shtetit shqiptar për të ndërtuar institucione kombëtare të qëndrueshme, profesionale dhe patriotike. Kjo histori është ndërtuar mbi sakrificë, përkushtim dhe vizion afatgjatë për krijimin e një ushtrie moderne dhe të aftë për mbrojtjen e vendit.

10 maji 1958 shënon një nga momentet më të rëndësishme në historinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.136, datë 10 maj 1958, u krijua për herë të parë Akademia Ushtarake Shqiptare, e njohur fillimisht si “Shkolla e Lartë Ushtarake”.

Krijimi i këtij institucioni përbënte lindjen e arsimit të lartë ushtarak shqiptar dhe një hap historik drejt konsolidimit të mendimit strategjik kombëtar.

RRUGËTIMI I ARSIMIT USHTARAK SHQIPTAR

Përpjekjet për krijimin e institucioneve ushtarake shqiptare nisën menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë. Në vitin 1928 u hap shkolla e parë ushtarake për përgatitjen e oficerëve shqiptarë, por ajo pati jetë të shkurtër për shkak të mungesës së fondeve dhe vështirësive ekonomike të shtetit të ri shqiptar.

Në vitin 1936 u hodh ideja për krijimin e një Akademie Ushtarake Kombëtare, por ajo nuk arriti të realizohej. Për dekada me radhë, oficerët shqiptarë vijuan studimet në akademitë ushtarake të Italisë, Austrisë, Francës, Greqisë dhe vendeve të tjera.

Megjithatë, mungesa e një institucioni kombëtar të arsimit ushtarak mbetej një boshllëk i madh për ushtrinë shqiptare.

Pas Çlirimit të vendit, nevoja për krijimin e një akademie kombëtare u bë emergjente. Fillimisht u organizuan kurse afatshkurtra dhe programe përgatitore për oficerët, ndërsa më 10 maj 1958 u realizua themelimi i Akademisë Ushtarake Shqiptare.

THOMA XHIXHO – THEMELUESI DHE KOMANDANTI I PARË I AKADEMISË

Një nga figurat më të rëndësishme në historinë e arsimit ushtarak shqiptar mbetet Gjeneralmajor Thoma Xhixho.

Menjëherë pas Çlirimit, ai u përzgjedh ndër oficerët e parë shqiptarë për studime të larta ushtarake në Akademinë “Frunze” në Bashkimin Sovjetik. Pas kthimit në Shqipëri, ai mbajti detyra të rëndësishme në ushtri, duke shërbyer si shef shtabi dhe komandant në disa prej njësisve më të rëndësishme të Ushtrisë Kombëtare.

Në dhjetor 1952, Xhixho u emërua komandant i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, ku organizoi Kursin e Lartë dyvjeçar të Oficerëve – eksperiencia e parë shqiptare e arsimit të avancuar ushtarak.

Me urdhrin nr. 400 të Ministrit të Mbrojtjes, gjeneralkolonel Beqir Balluku, Kolonel Thoma Xhixho u ngarkua me krijimin e Akademisë Ushtarake Shqiptare.

Së bashku me bashkëpunëtorët e tij: Niko Dulaku, Ferik Hoda, Elami Hado, Veip Aliaj, Hysni Rusi dhe Dhimitër Ndrenika, ai nisi punën për ngritjen e institucionit më të lartë ushtarak në vend.

Në kushtet kur Shqipëria nuk trashëgonte asnjë traditë të arsimit të lartë ushtarak, krijimi i Akademisë ishte një sfidë kombëtare.

Fillimisht u organizuan kurse gjashtëmujore dhe njëvjeçare për oficerë gjitharmësh dhe artilerie, ndërsa më pas Akademia u zgjerua duke përgatitur të gjitha armët dhe shërbimet që kërkonte ushtria shqiptare.

Kështu, për herë të parë në historinë e Shqipërisë, u krijua një institucion i lartë ushtarak i organizuar dhe drejtuar nga pedagogë dhe kuadro shqiptarë. Akademia u shndërrua në qendër të mendimit ushtarak shqiptar dhe laborator të zhvillimit të artit ushtarak kombëtar.

KONTRIBUTI I AKADEMISË NË PËRGATITJEN E OFICERËVE

Që prej themelimit të saj, Akademia e Forcave të Armatosura ka përgatitur mijëra oficerë, komandantë dhe drejtues ushtarakë.

Në Akademi janë formuar breza të tërë ushtarakësh që kanë shërbyer: në mbrojtjen territoriale të vendit, në strukturat drejtuese të ushtrisë, në misionet paqeruajtëse



ndërkombëtare, në strukturat e NATO-s, në institucione të sigurisë dhe mbrojtjes.

Në vitet ’70 Akademia fitoi të drejtën e dhënies së gradave shkencore dhe titujve akademikë.

Janë mbrojtur mbi 130 doktoratura dhe dhjetëra pedagogë e ushtarakë kanë marrë titujt: Doktor i Shkencave; Profesor i Asociuar; Profesor Doktor.

Akademia u bë qendra kryesore e studimeve ushtarake, strategjike dhe kërkimit shkencor në Shqipëri.

ARTI USHTARAK SHQIPTAR DHE PUNA SHKENCORE

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mendimit ushtarak shqiptar pati Gjeneral Thoma Xhixho.

Ai ishte një nga hartuesit kryesorë të dokumenteve bazë të Artit Ushtarak Shqiptar të Luftës Popullore, përfshirë: “Referatin e Ministrisë së Mbrojtjes” të vitit 1963; “Tezat e Këshillit të Mbrojtjes” të vitit 1967.

Këto dokumente u bënë baza teorike dhe strategjike e mbrojtjes së vendit për dekada me radhë.

Ai kontribuoi gjithashtu në: studimet taktike të luftimit; përgatitjen luftarake të njësisve; historinë ushtarake shqiptare; edukimin dhe formimin profesional të oficerëve.

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA SOT

Sot Akademia e Forcave të Armatosura është institucioni më i lartë arsimor ushtarak në Shqipëri dhe institucioni i vetëm që ofron programe studimi në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në të tre ciklet.

Aktualisht zhvillohen:

- Programi i Shkencave Ushtarake;
 - Programi i Navigimit Detar;
 - Programi IT (Information Technology)
 - Kursi i Përgatitjes së Oficerit të Ri;
 - Master Profesional në Mbrojtjen Kibernetike.
- Akademia ndodhet në një proces të thellë transformimi sipas modelit të Akademisë Ushtarake Amerikane “West Point”.

Në bashkëpunim me:

- SHBA;
 - NATO;
 - Universitetin e Tiranës;
 - Universitetin Politeknik;
 - Universitetin “Aleksandër Moisiu”;
 - Universitetin Luarasi;
 - Universitetin Barleti;
 - Qendrën Marshall;
- po modernizohen: kurrikulat; infrastruktura; trajnimet pedagogjike; standardet akademike. Qëllimi është krijimi i një sistemi modern arsimor ushtarak të standardeve euroatlantike.

BIBLIOTEKA E AKADEMISË – QENDËR E DIJES USHTARAKE

Bashkë me Akademinë, më 10 maj 1958 u krijua edhe biblioteka e saj.

Në vitet e para ajo dispononte: leksione; dispenca metodike; rregullore; manuale ushtarake; botime shkencore dhe literaturë artistike.

Në vitin 1984, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, e gjithë literatura e huaj ushtarake e reparteve të ushtrisë u përqendrua në bibliotekën e Akademisë.

Pas vitit 2004, biblioteka pësoi transformim të plotë infrastrukturor dhe profesional.

Sot biblioteka disponon: 9467 tituj; 46397 kopje; literaturë shqip dhe të huaj; enciklopedi ndërkombëtare; doktoratura;

periodikë ushtarakë; punime shkencore; materiale kërkimore.

Infrastruktura përfshin: dy fonde kryesore; dy salla leximi; sallë leksionesh; sallë informacioni me kompjuterë; ambiente studimi dhe mbledhjeje.

Biblioteka i shërben: Akademisë; Forcave të Armatosura; studiuesve; studentëve; kërkuesve shkencorë.

SFIDAT E KOHËS DHE E ARDHMJA E ARSIMIT USHTARAK

Mjedisi aktual i sigurisë është më kompleks se kurrë më parë. Konfliktet hibride, zhvillimi teknologjik, lufta kibernetike dhe sfidat globale kërkojnë një brez të ri oficerësh: të arsimuar; kritikë në mendim; të aftë për drejtim; bashkëpunues; profesionistë; ndërveprues në mjedise ndërkombëtare.

Akademia synon të përgatisë oficerë që: dinë jo vetëm “çfarë” të mendojnë; por edhe “si” të mendojnë.

Profesioni i oficerit modern kërkon: kulturë strategjike; lidhshmëri; diplomaci; etikë; profesionalizëm; aftësi menaxheriale.

Në këtë kuptim, Akademia e Forcave të Armatosura mbetet një institucion kyç për sigurinë kombëtare dhe të ardhmen euroatlantike të Shqipërisë.

68 vite pas themelimit të saj, Akademia e Forcave të Armatosura vazhdon të mbetet simbol i dijes ushtarake shqiptare.

Ajo ka edukuar breza të tërë oficerësh, ka zhvilluar mendimin ushtarak shqiptar dhe ka kontribuar në modernizimin e Forcave të Armatosura.

Në këtë përvjetor të rëndësishëm nderohen: pedagogët; komandantët; studiuesit; oficerët; studentët; ushtarakët, që me përkushtim dhe sakrificë kanë ndërtuar dhe forcuar këtë institucion elitare të shtetit shqiptar.

**Lavdi traditës së arsimit ushtarak shqiptar!
Lavdi Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë!**

Kuçova - Nga Djepi i Aviacionit Luftarak Shqiptar në Bazë Strategjike të NATO-s

71 Vjet Aviacion Luftarak në Kuçovë

Në historinë e Forcave të Armatosura shqiptare, pak ngjarje kanë pasur peshën simbolike, ushtarake dhe strategjike që mbart krijimi i Regjimentit të Aviacionit Luftarak në Kuçovë. Data 15 maj 1955 shënon lindjen e një epike të re për mbrojtjen ajrore shqiptare, një moment historik kur Shqipëria, një vend i vogël dhe me mundësi të kufizuara ekonomike, hodhi themelet e aviacionit të saj reaktiv luftarak.

Sot, pas shtatë dekadash, historia e kësaj baze nuk është vetëm histori avionësh, pilotësh apo teknologjie ushtarake. Është histori përkushtimi, sakrificë, profesionalizmi dhe vizioni strategjik. Nga avionët e parë MiG-15 të viteve '50 deri te transformimi i Kuçovës në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s, ky repart mbetet një nga simbolet më të rëndësishme të modernizimit dhe identitetit ushtarak shqiptar.

Fillimet e një epike të re

Regjimenti i Aviacionit Luftarak në Kuçovë u krijua zyrtarisht, më 15 maj 1955, ndërsa më vonë u ligjërua me vendimin nr. 81, datë 06.11.1956 të Kuvendit Popullor. Ai ishte repartit i parë i aviacionit shqiptar i pajisur me avionë reaktivë MiG-15, duke shënuar hyrjen e Shqipërisë në epokën moderne të aviacionit luftarak.

Avionët e parë u montuan dhe u kolauduan në aerodromin e Tiranës nga specialistë sovjetikë dhe më pas u dislokuan në aerodromin e sapondërtuar të Kuçovës nga xhenerët shqiptarë. Në ceremoninë e krijimit, regjimentit iu dorëzua Flamuri Luftarak "Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës PEZA", një simbol krenarie dhe përgjegjësie për brezat e aviatorëve që do të shërbenin në këtë repart.

Në krye të regjimentit u caktua kolonel Niko Hoxha, një nga figurat më të shquara të aviacionit shqiptar, i cili do të mbetet përgjithmonë simbol i profesionalizmit dhe sakrificës në armën e aviacionit.

Brezi pionier i aviatorëve shqiptarë

Krijimi i regjimentit lidhet ngushtë me një brez pilotësh dhe teknikësh që hodhën themelet e aviacionit modern shqiptar. Shumë prej tyre ishin përgatitur fillimisht në ish-Jugosllavi dhe më pas në Bashkimin Sovjetik, duke sjellë në Shqipëri përvojën më të avancuar të kohës.

Emra si **Niko Hoxha, Edip Ohri, Fahri Bubësi, Babaçe Faiku, Vasil Trasha, Peço Polena, Masar Aga, Elmas Hasanmataj, Koço Andoni, Tomorr Avdia, Goxho Kondi** e shumë të tjerë, mbeten sot pjesë e historisë së artë të aviacionit shqiptar.

Po aq i rëndësishëm ishte edhe kontributi i inxhinierëve dhe teknikëve të aviacionit, të cilët garantuan funksionimin dhe mirëmbajtjen e flotës ajrore në kushte të vështira infrastrukturore dhe teknologjike.

Kuçova, shkolla e profesionalizmit dhe inovacionit

Vetëm pak vite pas krijimit të regjimentit, Kuçova u kthye në qendrën kryesore të përgatitjes së aviatorëve shqiptarë. Në vitin 1957 filloi përgatitja e pilotëve për Klasin e Parë, ndërsa emra si Niko Hoxha, Fahri Bubësi, Babaçe Faiku dhe Edip Ohri u titulluan ndër pilotët më të kualifikuar të aviacionit luftarak shqiptar.

Por historia e këtij repartit nuk lidhet vetëm me fluturimet dhe stërvitjet. Kuçova u kthye edhe në një qendër inovacioni teknik dhe industrial për aviacionin shqiptar.



Në vitin 1959 filloi puna për remonin e mesëm të avionëve MiG-15 me forcat dhe kapacitetet vendase. Ishte një hap i jashtëzakonshëm për kohën, duke marrë parasysh vështirësitë teknike dhe distancën nga Bashkimi Sovjetik, vendi prodhues i avionëve.

Inxhinierë si Stefan Kaggjini, Nexhip Manushi, Nasi Themeli dhe specialistë të tjerë të aviacionit e industrisë së naftës realizuan eksperimente dhe projekte që dëshmuar aftësitë profesionale të specialistëve shqiptarë.

Një nga momentet më domethënëse ishte eksperimentimi i parë i karburantit shqiptar për avionët reaktivë në vitin 1961. Vetë komandanti Niko Hoxha realizoi me sukses fluturimin provë me avionin MiG-15 nr. 332, duke provuar cilësinë e karburantit të prodhuar në vend.

Mbrojtja e hapësirës ajrore shqiptare

Regjimenti i Kuçovës luajti rol kyç në garantimin e sovranitetit ajror të Shqipërisë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.

Në dhjetor të vitit 1957, pas sinjalizimit për shkelje të hapësirës ajrore shqiptare, avionët e regjimentit detyruan të ulej një avion transporti anglez "Skymaster". Vetëm një vit më vonë, më 23 dhjetor 1958, një avion amerikan i tipit T-33 u detyrua të ulej pas ndërhyrjes së avionëve MiG-15 të ngritur nga Kuçova.

Këto episode treguan jo vetëm gatishmërinë luftarake të repartit, por edhe nivelin e lartë të përgatitjes së pilotëve shqiptarë në një periudhë shumë të tensionuar ndërkombëtare.

Stërvitjet, ribazimet dhe modernizimi

Në dekadat që pasuan, regjimenti mori pjesë në një numër të madh stërvitjesh kombëtare dhe operacionale, duke eksperimentuar ulje dhe ngritje në aerodrome fushore në Shkodër, Pish-Poro, Cërrik dhe Korçë.

Në vitin 1965 u krijua skuadrilja e tretë reaktive-mësimore për përgatitjen e pilotëve dhe teknikëve të rinj, ndërsa në vitin 1966 repartit u pajis me avionët MiG-17.

Qershori i vitit 1970 shënoi fillimin e fluturimeve me

avionët MiG-19, një tjetër hap i rëndësishëm në modernizimin e aviacionit luftarak shqiptar.

Në vitin 1974 regjimenti mori pjesë në paradën ushtarake me 27 avionë në fluturim, një demonstrim force dhe profesionalizmi që mbetet ndër momentet më mbresëlënëse të aviacionit shqiptar.

Kuçova dhe kinematografia shqiptare

Një aspekt më pak i njohur, por po aq interesant, ishte edhe kontributi i repartit në realizimin e filmit artistik "Gjurmë në kaltërsi" të Kinostudios "Shqipëria e Re" në vitin 1981.

Pilotë si Harilla Rebi, Viktor Vangjeli, Agim Balili dhe Gjergji Spaho jo vetëm u bënë protagonistë të filmit, por realizuan edhe dhjetëra fluturime në funksion të xhirimeve, duke sjellë në ekran jetën dhe profesionalizmin e aviatorëve shqiptarë.

Sakrifica dhe heroizëm

Historia e Regjimentit të Kuçovës është edhe histori sakrificë. Shumë pilotë dhe specialistë të aviacionit shqiptar shërbyen me përkushtim në kushte të vështira dhe me rrezik të lartë.

Figura e kolonel Niko Hoxhës mbetet ndër më emblematicet. Ai ra në krye të detyrës më 21 nëntor 1965, ndërsa kryente detyrën e komandantit të Regjimentit të Rinasit, duke mbetur simbol i përjetshëm i aviacionit luftarak shqiptar.

Nga baza e MiG-ve te Baza Ajrore Taktike e NATO-s

Sot, pas 71 vitesh histori, Kuçova ka hyrë në një epokë të re. Transformimi i saj në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s përfaqëson një zhvillim me rëndësi strategjike jo vetëm për Shqipërinë, por për gjithë rajonin.

Me infrastrukturë moderne, baza tashmë mbështet flotën shqiptare të helikopterëve, dronëve të armatosur dhe operacionet e avionëve luftarakë të Aleancës.

Prania e helikopterëve "Black Hawk" dhe dronëve "Bayraktar" shënon fillimin e një faze të re modernizimi të Forcave Ajrore shqiptare dhe rritjes së kapaciteteve operacionale të vendit.

Si baza më e rëndësishme ajrore e NATO-s në rajon, Kuçova i jep Shqipërisë një dimension të ri gjeostrategjik dhe e kthen vendin tonë në një pikë kyçe të sigurisë euro-atlantike në Ballkanin Perëndimor.

Një trashëgimi që vazhdon

Historia e Regjimentit të Aviacionit Luftarak të Kuçovës është histori e një transformimi të jashtëzakonshëm. Nga pistat e thjeshta të viteve '50 te standardet moderne të NATO-s, kjo bazë ka qenë dëshmi e aftësisë së Forcave tona të Armatosura për t'u përshtatur, modernizuar dhe zhvilluar.

Sot, kur Shqipëria është pjesë aktive e Aleancës Atlantike, Kuçova mbetet simbol i vazhdimësisë, profesionalizmit dhe vizionit strategjik të aviacionit shqiptar.

71-vjetori i këtij regjimenti nuk është vetëm një përvjetor historik. Është një moment reflektimi për rrugën e gjatë të aviacionit tonë ushtarak dhe njëkohësisht një pikënisje për të ardhmen e re të Forcave Ajrore shqiptare në kuadër të NATO-s.



“SHQIPËRIA SOT FLET ME ZËRIN E SAJ NË NATO”

Nga përvoja në SHAPE te sfidat e sigurisë moderne dhe perspektiva euroatlantike



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në më shumë se një dekadë anëtarësim në NATO, Shqipëria ka kaluar nga faza e integritit formal drejt një roli gjithnjë e më aktiv në strukturat vendimmarrëse, operacionale dhe strategjike të Aleancës. Përfaqësimi i vendit tonë në nivelet më të larta të komandimit të NATO-s është tashmë një realitet që dëshmon pjekurinë profesionale të Forcave të Armatosura dhe besimin që aleatët kanë ndaj Shqipërisë.

Një nga këto përfaqësime me peshë të veçantë është ai në Komandën Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), në Mons të Belgjikës, struktura më e rëndësishme operacionale e NATO-s. Në këtë qendër strategjike, ku planifikohen dhe koordinohen operacionet, stërvitjet dhe politikat e sigurisë së Aleancës, Shqipëria ka mbajtur një nga postet më të larta drejtuese në fushën e marrëdhënieve civilo-ushtarake.

Gjeneral brigade (R) Editsion Zarka, i cili gjatë periudhës 2022–2025 shërbeu si Asistent i Shefit të Shtabit për Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake në SHAPE, ndan në këtë intervistë për gazetën “Ushtria” përvojën e tij në zemër të strukturave strategjike të NATO-s, sfidat e sigurisë pas agresionit rus ndaj Ukrainës, transformimin e konceptit të mbrojtjes kolektive, rëndësinë e koordinimit civilo-ushtarak dhe perspektivën e Shqipërisë në arkitekturën euro-atlantike të sigurisë.

Në një kohë kur siguria nuk konceptohet më vetëm si çështje ushtarake, por si ndërthurje e kapaciteteve civile, institucionale, ekonomike dhe strategjike, kjo intervistë sjell një këndvështrim të thelluar mbi rolin që Shqipëria mund dhe duhet të luajë në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Zoti Gjeneral, gjatë periudhës 2022–2025 ju shërbyet në SHAPE, në postin e Asistentit të Shefit të Shtabit për Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake. Çfarë përfaqëson ky pozicion për Forcat tona të Armatosura dhe për Shqipërinë në tërësi?

Shërbimi në SHAPE është një përgjegjësi shumë e madhe profesionale dhe institucionale, jo vetëm për individin që e mban atë post, por mbi të gjitha për vendin që përfaqëson. SHAPE është zemra operacionale e NATO-s, qendra ku ndërthuren planifikimi strategjik, drejtimi operacional dhe koordinimi shumëkombësh i Aleancës. Të jesh pjesë e kësaj strukture dhe të mbash një pozicion drejtues në të është një vlerësim shumë i rëndësishëm për Shqipërinë dhe Forcat tona të Armatosura.

Fakti që Shqipëria e mban këtë post prej disa vitesh në rotacion me Francën tregon qartë nivelin e besimit që NATO ka ndaj kapaciteteve tona profesionale dhe institucionale. Ky nuk është thjesht një pozicion administrativ apo ceremonial; është një funksion strategjik që lidhet drejtpërdrejt me koordinimin e planeve, politikave dhe aktiviteteve që kanë ndikim në të gjithë spektrin operacional të Aleancës.

Për Shqipërinë kjo ka edhe një domethënie simbolike dhe politike shumë të rëndësishme. Vendi ynë ka kaluar nga statusi i një vendi që dikur kërkonte siguri dhe mbështetje, në një vend që kontribuon aktivisht në sigurinë kolektive euro-atlantike. Ky transformim nuk ka ardhur rastësisht. Ai është rezultat i reformave të vazhdueshme, investimeve në profesionalizëm, standardizim dhe interoperabilitet me aleatët.

Nga ana tjetër, mbajtja e një posti të tillë rrit edhe më shumë përgjegjësinë tonë. Duhet të dëshmosh çdo ditë se



Gjeneral brigade (R)
Editson Zarka

mund të performosh në të njëjtin nivel me vendet më të avancuara të NATO-s, të ruash ritmin e proceseve komplekse strategjike dhe të kontribuosh me profesionalizëm në vendimmarrje.

Ju përmendët rotacionin me Francën. Sa domethënës është ky fakt për një vend relativisht të vogël dhe me anëtarësim më të vonshëm në NATO si Shqipëria?

Është jashtëzakonisht domethënës. Franca është një nga vendet themeluese të NATO-s dhe një nga fuqitë më të mëdha ushtarake të Aleancës. Të jesh në rotacion me një vend të tillë për një post strategjik do të thotë se standardet e performancës janë shumë të larta.

Për ne kjo ka qenë një sfidë profesionale, por njëkohësisht edhe një mundësi shumë e mirë për të treguar se Shqipëria ka kapacitete reale për të kontribuar në nivelet më të larta të komandimit ushtarak ndërkombëtar.

Në praktikë, kjo kërkon jo vetëm njohuri të thelluara ushtarake, por edhe aftësi drejtuese, njohje të dimensionit diplomatik dhe strategjik, aftësi për të punuar në ambiente shumëkombëshe dhe për të bashkërenduar interesa të ndryshme të vendeve aleate.

Për mua personalisht, por edhe për çdo oficer shqiptar që shërben në këto struktura, është një përgjegjësi e madhe për të përfaqësuar me dinjitet vendin tonë. Çdo performancë individuale reflekton drejtpërdrejt mbi imazhin dhe besueshmërinë e Shqipërisë në Aleancë.

Mendoj se kjo përvojë ka treguar se Forcat tona të Armatosura kanë arritur një nivel profesional shumë më të lartë krahasuar me vitet e para të anëtarësimit në NATO.

Cili është konkretisht roli i strukturave të marrëdhënieve civilo-ushtarake në SHAPE dhe pse ky dimension është bërë kaq i rëndësishëm për NATO-n moderne?

Në mjedisin aktual të sigurisë, asnjë operacion ushtarak nuk mund të zhvillohet i izoluar nga dimensionin civil. Konfliktet moderne janë shumëdimensionale dhe ndikojnë drejtpërdrejt mbi popullsinë civile, infrastrukturën kritike, ekonominë, institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare.

Pikërisht për këtë arsye strukturat e marrëdhënieve civilo-ushtarake – ose CIMIC, kanë marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në NATO.

Roli i tyre kryesor është të krijojnë urën lidhëse ndërmjet komandës ushtarake dhe mjedisit civil. Kjo përfshin koordinimin me qeveri, institucione shtetërore, organizata ndërkombëtare, organizata humanitare dhe aktorë të tjerë civilë që operojnë në zona krize apo konfliktesh.

Në SHAPE, struktura CIMIC merret me integrimin e faktorëve civilë në planifikimin operacional dhe strategjik të Aleancës. Kjo do të thotë që çdo plan ushtarak duhet të marrë në konsideratë ndikimin mbi popullsinë civile, infrastrukturën, rrjetet energjetike, transportin, emergjencat



humanitare dhe shumë elementë të tjerë.

Gjithashtu, kjo strukturë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e koncepteve, doktrinave, standardeve dhe procedurave të NATO-s në fushën civilo-ushtarake.

Në realitetin e sotëm, ku kërcënimet hibride, sulmet kibernetike, dezinformimi dhe lufta asimetrike janë bërë pjesë e sfidave të sigurisë, dimensionin civil është po aq i rëndësishëm sa ai ushtarak.

Gjatë mandatit tuaj, Evropa u përball me luftën në Ukrainë dhe me krizën më të madhe të sigurisë që nga Lufta e Ftohtë. Si ndikoi kjo situatë në strukturat dhe prioritetet e NATO-s?

Agresioni rus ndaj Ukrainës ndryshoi në mënyrë të menjëhershme mjedisin strategjik të sigurisë në Evropë. NATO u përball me nevojën për të rishikuar shumë nga konceptet, planet dhe prioritetet e saj operative.

Aleanca hyri në një proces transformimi të thellë që

kishte në qendër forcimin e mbrojtjes kolektive dhe rritjen e gatishmërisë operacionale. U shtuan ndjeshëm stërvitjet ushtarake, veçanërisht ato të lidhura me zbatimin e Nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit, që lidhet me mbrojtjen kolektive të vendeve anëtare.

Gjithashtu, u rrit shumë rëndësia e konceptit të resilience – ose qëndrueshmërisë kombëtare dhe kolektive. NATO kuptoi qartë se mbrojtja moderne nuk lidhet vetëm me forcat ushtarake, por edhe me aftësinë e shteteve për të garantuar funksionimin e institucioneve, infrastrukturës kritike, energjisë, transportit dhe komunikimeve në kushte krize.

Për strukturat civilo-ushtarake kjo periudhë solli një intensifikim të jashtëzakonshëm të punës. U rrit koordinimi me strukturat civile kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe partnerët strategjikë.

Gjithashtu, u zgjerua përfshirja e komponentit civil në stërvitje dhe në planifikimin operacional, sepse u kuptua se çdo krizë moderne ka pasojat e drejtpërdrejta humanitare dhe sociale.

Cili ishte niveli i bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, Kombet e Bashkuara dhe organizatat humanitare gjatë kësaj periudhe?

Bashkëpunimi me strukturat civile dhe organizatat ndërkombëtare u bë shumë më intensiv gjatë kësaj periudhe. Në kushtet e krizës së sigurisë në Evropë, u kuptua edhe më qartë se NATO nuk mund të veprojë e vetme pa koordinim me partnerët strategjikë civilë.

Bashkëpunimi me Bashkimin Evropian mori një dimension të ri, sidomos në fushat që lidhen me mbrojtjen civile, sigurinë energjetike, mobilitetin ushtarak dhe menaxhimin e krizave.

Po kështu, u thellua bashkëpunimi me organizata si Kombet e Bashkuara, UN OCHA dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Këto organizata kanë një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e civilëve, menaxhimin e emergjencave humanitare dhe koordinimin e ndihmave në zona konfliktit.

Një aspekt shumë i rëndësishëm ishte jo vetëm nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, por zbatimi praktik i tyre përmes trajnimeve të përbashkëta, stërvitjeve dhe harmonizimit të procedurave operacionale.

Gjithashtu, bashkëpunimi me Komandën Amerikane në Evropë – EUCOM – ishte shumë intensiv, duke pasur parasysh rolin strategjik që SHBA luan në sigurinë euro-atlantike.

Çfarë përfiton konkretisht Shqipëria nga ky nivel përfaqësimi në NATO?

Përfitimet janë shumëdimensionale dhe afatgjata. Së pari, rritet niveli profesional i personelit tonë ushtarak. Oficerët që shërbejnë në këto struktura fitojnë njohuri të avancuara strategjike dhe operacionale, të cilat më pas transferohen në institucionet tona kombëtare.

Së dyti, Shqipëria fiton akses të drejtpërdrejtë në zhvillimet më të fundit doktrinale dhe konceptuale të NATO-s. Kjo ndihmon në rritjen e ndërvprueshmërisë dhe standardizimit me aleatët.

Një përfitim tjetër shumë i rëndësishëm lidhet me dimensionin civilo-ushtarak. Shqipëria ka një avantazh specifik, pasi strukturat e emergjencave civile janë pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo krijon mundësi shumë të mira për koordinim të shpejtë dhe efikas në raste krizash apo emergjencash.

Gjithashtu, përvoja e NATO-s ndihmon në zhvillimin e kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e krizave, mbrojtjen civile dhe sigurinë infrastrukturale.

Në kushtet e sotme, rëndësi shumë të madhe kanë projektet infrastrukturale me përdorim të dyfishtë – civil dhe ushtarak – si portet, aeroportet, korridoret rrugore dhe infrastruktura energjetike.

Si e shihni të ardhmen e Shqipërisë në NATO dhe perspektivën evropiane të vendit?

Mendoj se Shqipëria ka potencial real për të rritur më tej rolin e saj në NATO dhe njëkohësisht për të avancuar në procesin e integritimit evropian.

Vendi ynë ka fituar një përvojë shumë të vlefshme në operacione, misione dhe struktura shumëkombëshe. Kjo përvojë duhet të shfrytëzohet për të ndërtuar kapacitete edhe më të avancuara në të ardhmen.

Sigurisht që kjo kërkon investime të qëndrueshme në burime njerëzore, modernizim të kapaciteteve ushtarake dhe forcim të institucioneve të sigurisë kombëtare.

Shqipëria ka treguar se është një aleate serioze dhe e besueshme. Besoj se me të njëjtin angazhim dhe vizion strategjik, vendi ynë mund të synojë nivele edhe më të larta përfaqësimi në strukturat euro-atlantike dhe të përmbushë me sukses objektivat e integritimit në Bashkimin Evropian.

Në përfundim, pas mbylljes së karrierës aktive ushtarake, në çfarë mënyre vijoni të kontribuoni në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes?

Karriera aktive ushtarake mund të përfundojë, por përgjegjësia për të kontribuar ndaj vendit mbetet gjithmonë. Përvoja e fituar gjatë viteve në strukturat kombëtare dhe ato të NATO-s është një kapital profesional që duhet ndarë me brezat e rinj dhe me institucionet e sigurisë.

Aktualisht vijoj të jem i angazhuar në mënyrë modeste në diskutime, analiza dhe aktivitete që lidhen me çështjet strategjike të sigurisë dhe mbrojtjes, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal.

Besoj se sot më shumë se kurrë kemi nevojë për kulturë strategjike, për vizion afatgjatë dhe për bashkëpunim të ngushtë ndër-institucional, në mënyrë që Shqipëria të vazhdojë të jetë një faktor stabiliteti dhe sigurie në rajon dhe në Aleancën Euro-Atlantike.



100-VJETORI I LINDJES EDIP OHRI, LEGJENDA E AVIACIONIT SHQIPTAR



HALIL RAMA
MJESHTËR I MADH

PINJOLL I FAMILJES SË ISMAIL QEMAL BEJ VLORËS

Ish-komandanti i Aviacionit të Shqipërisë, kolonel Edip Ohri, ka lindur në Strugë në dekadën e parë të muajit janar të vitit 1926, por që zyrtarisht si ditëlindje e tij njihet data 8 maj 1926, ndërsa gati tërë jetën deri në vdekje e kaloi në Tiranë.

Është pjesëtar-fëmijë i familjes fisnike strugane Emirzade – Ohri, e pastaj fëmijë i birësuar i Qazim bej Qemal Vlorës, djalit të Ismail Qemal bej Vlorës.

Ushtaraku i karrierës, Edip Ohri, shumë herët mbetet pa babanë, Inajet Murat Emirzade – që më pas do të ndryshojë mbiemrin në Ohri - bashkë me dy motrat e tija, Edibënë dhe Hyrmeten dhe vëllain, Dashamirin, në vitet kur babai i tij, Inajet bej Ohri, ishte emëruar kryetar i komunës Shën Vlash të Durrësit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Edip Ohri pa hezitim iu bashkëngjiti formacioneve luftarake të LANÇ-it, duke dëshmuar shpirtin e tij lirisht dhe antiokupatorial ndaj tokave shqiptare. Këtë veti, këtë karakteristikë nuk e posedonte vetëm Edipi, por edhe fëmijët tjerë të Inajet Ohrit, Edibeja, Hyrmetja dhe Dashamiri, që vërtetonte brumosjen e tyre për ta dashur atdheun dhe popullin e tyre të lirë.

Shkollimin fillor e ka filluar në Strugë, ndërsa më pastaj atë e ka vazhduar në Shqipëri, duke qenë edhe normalist i Normales së famshme të Elbasanit, për të vazhduar studimet në shumë Akademi ushtarake të aviacionit.

Nga ajo që ishte fëmijë i familjes fisnike Emirzade – Ohri, e pastaj fëmijë i birësuar i Qazim bej Qemalit, djalit të Ismail Qemal bej Vlorës, nuk ka përfutur asgjë, posikur që nuk kanë përfutur as familjarët e tjerë të Ismail Qemal bej Vlorës. Shumëkush në Tiranë, as nga më të afërmit, nuk kanë ditur deri para sa kohe, se është fëmijë të birësuar i Qazim bej Qemal Vlorës mbase nga modestia. Mirëpo, rëndësi ka ajo që vetë Edipi vazhdimisht e ka thënë: se Qazim beu, i ka brumosur dhe i ka edukuar që ta duan popullin shqiptar dhe Shqipërinë. Këtë amanet Edip Ohri ia ka çuar në vend plotësisht. Vajzat e tij shembullore, Mirjana dhe Arjana, si dhe mbesa Kleida Hadëri ndjehen krenare për veprën e lavdishme të babait e gjyshit të tyre.

92 VJET JETË, 92 VJET HISTORI PËR EDIP OHRIN

Nëntëdhjetë e dy vjet jetë, 92 vjet histori për Edip Ohrin sepse nga Normalja e Elbasanit, ai është pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacional Çlirimtare bashkë me të vëllain Dashamirin dhe motrat, Edibënë dhe Hyrmeten. Pas luftës, pas çlirimit të Shqipërisë, Edip Ohri i kushtohet profesionit të ushtarakut, aviacionit, duke u bërë edhe komandant i Forcave Ajrore të Ushtrisë Shqiptare, për t'u shndërruar në "Legjendën e aviacionit shqiptar", kolos prej ushtaraku, intelektual, patrioti dhe figure madhore shqiptare.

Pa dyshim se një nga kolosët që ka dhënë Struga, ose fushëgropa e Strugës e Ohrit, krahas emrave të shquar si Hamdi bej Ohri, Zyhdi Ohri, Dr. Myrteza Ali Struga, Dervish Hima, Mustafa Baroti, Nuri Sojliu, Dr. Ibrahim Temo, kësaj



liste i duhet shtuar edhe emri i Edip Ohrit, për meritat e tij që ka për Shqipërinë, për shqiptarinë në përgjithësi e bashkë me këtë natyrisht edhe për Strugën.

Ai, me personalitetin e tij, me karakterin, punën, sjelljen, përkushtimin, qëndrimin, vlerësimin e drejtë, vuajtjet, përjetimet gjatë jetës dhe karrierës së tij, kurrë nuk ka bërë

asnjë veprim që do ta relativizonte Shqipërinë, shqiptarinë dhe Strugën, por gjithmonë ka qenë ballëllartë dhe krenar për Strugën.

Edip Ohri, me jetën, punën, veprimtarinë, përkushtimin, profesionalizmin, patriotizmin, nacionalizmin, vuajtjet, përjetimet e shumëllojshme, nuk e nderoi vetëm emrin dhe veten



e tij, por nderoi dhe madhëroi e nderoi emrin e familjes Ohri, madhëroi e nderoi emrin e familjes së Ismail Qemal bej Vlora, madhëroi e nderoi Strugën dhe popullin strugan, madhëroi dhe nderoi Shqipërinë, madhëroi dhe nderoi shqiptarinë.

Edip Ohri mbetet një ndër emrat e përveçëm të figurave madhore shqiptare, mbetet kolos në kujtesën e pashlyeshme të historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Kur është fjala për vendlindjen e tij, për Strugën, Edip Ohri, ky kolos, sa herë që ka folur për jetën, veprën, arritjet dhe natyrisht edhe për vuajtjet e tija vazhdimisht përsëriste se ndjehej krenar për Strugën dhe popullin e Strugës. Vazhdimisht ai shprehej se: “Kurrë gjatë jetës punës dhe karrierës sime e tonën, nuk kam bërë dhe nuk kemi bërë asnjë veprim që do ta relativizonte dhe do ta turpëronte Strugën, por gjithmonë kam qenë dhe kemi qenë ballëlartë dhe krenar për Strugën. Më kanë akuzuar pse kam lindur dhe pse kemi lindur në Strugë, por vazhdimisht kam qenë dhe kemi qenë krenar për Strugën. Jam dhe jemi të lindur në Strugë, dhe Struga është vendlindja jonë, me të cilën gjithmonë pra jemi krenuar. Gjithmonë e kemi nderuar e lartësuar Strugën. Kemi qenë dhe jemi krenar. Kurrë, as në momentet më të vështira kur më kanë akuzuar pse kam lindur në Strugë, nuk e kam turpëruar Strugën por e kam madhëruar e lartësuar”.

**4000 ORË FLUTURIME, PA E NDËRPRERË
ASNJËHERË PUNËN DREJTUESE SI KOMANDANT**

Edip Ohri ishte një pilot i madh. Nuk kishte mjet ajror në Shqipëri, me të cilin nuk kishte fluturuar; me avionët luftarakë me helikë të tipit JAK dhe PO, me avionin bombardues, me avionët gjuajtës me helikë, me avionët reaktivë MIG-15, MIG-17, me supersonikun MIG-19; me helikopterët MI-1 e MI-4, si dhe me avionët e transportit. Ai realizoi rreth 4000 orë fluturime, pa e ndërprerë asnjëherë punën drejtuese si

komandant.

Në vitet që ai drejtoi Aviacionin Luftarak Shqiptar datohen të gjithë rikonstruksionet dhe ndërtimet e mëdha të infrastrukturës së kësaj arme si, në Aerodromin e Kuçovës në Heli-dromin e Farkës, në Aerodromin e Rinasit, në Fushën e Pishë-Poros, më Aerodromin e Gjadrit etj.

Në funksionin e komandantit, Edipi e ka përfaqësuar Aviacionin Luftarak Shqiptar si ekspert ushtarak në organizmat e Traktatit të Varshavës dhe më pas në Republikën Popullore të Kinës. Ai ka qenë pjesëtar i delegacioneve shtetërore e ushtarake që janë takuar me Hrushovin në ish-BS, me Komandantin e Traktatit të Varshavës, me Çu En Lain e Mao Ce Dunin në Kinë, etj.

Edip Ohri ishte dhe një prind shembullor. Gjatë gjithë jetës së tij, me gjithë kalvarin e vuajtjeve u dhuroi bashkëshortes e dy vajzave që ishin dhe janë krenaria e gëzimi i tij, duke dëshmuar kujdesin e dashurinë e babait të tyre, ndaj fëmijëve. Ai ishte prind, mësues dhe edukator, që i rriti dhe edukoi ato me ndershmërinë dhe besnikërinë e patundur ndaj popullit e Atdheut tonë të dashur. Ai u dha atyre forcë, pathyeshmëri e krenari.

Ndonëse ndonjë kalemxhi i paguar s'ngurron të përbaltë personalitetin e ish-ushtarakut me kontribut të çmuar gjatë LANÇ-it dhe në krijimin e modernizimit e Ushtrisë Shqiptare, duke sajuar “urdhra” të tij për të sulmuar Jugun e Shqipërisë në vitin e mbrapshtë '97, ndërkohë që ishte në vitet e pensionit të pleqërisë, Edip Ohri njihet si figura më e shquar e Aviacionit Luftarak shqiptar, por edhe si një nga ushtarakët më në zë të Ushtrisë. Përgjigjja më e saktë për këta shpifarakë është monografia “Edip Ohri, legjenda e aviacionit”, e autorit të mirënjohur Agustin Z. Gjinaj. Nuk mund të mohohet fakti që koloneli në pension e përjetoi me dhimbje revolucionin bolshevik të '97-tës, por pas kalvarit në burgjet e diktaturës ai i qe përkushtuar totalisht familjes dhe Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it (OBVL), si sekretar i përgjithshëm i

saj për afro dy dekada, derisa ndërroi jetë para gjashtë vitesh (më 21 shkurt 2017) në moshën 92-vjeçare. Siç shkruan autori Gjinaj: “Ai ishte një pilot i madh që fluturoi me të gjithë tipat e avionëve, ndërkohë që mbi 20 vite ka qenë komandant i Armës së Aviacionit”.

QËNDRIMI STOIK NË BURGJET E DIKTATURËS

Ndonëse njihej si legjenda e aviacionit ushtarak shqiptar, në kulmin e karrierës, Edip Ohri u dënua si pjesë e grupit të “puçistëve” të Ushtrisë që do të përmbysnin pushtetin popullor. Ndërkaq, prej vitit 1974 – Edip Ohri ishte zgjedhur edhe deputet i Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ndërsa në moshën 49-vjeçare, në kulmin e sukseseve e të arritjeve në punë, u lirua nga detyra për t'u arrestuar vetëm pak kohë më vonë, në ditën e lindjes së Enver Hoxhës me akuzën se donte të rrëzonte pushtetin popullor me anën e terrorit.

U arrestua, më 16 tetor 1980, me akuzën absurde për përgatitjen e një grushti shteti ushtarak dhe propagandë antishqiptare. Pas disa muaj hetimi, Edip Ohri, së bashku me gjashtë oficerë të tjerë del në gjyq. Në janar të vitit 1981, dënohet me 14 vjet burg, dënim i kryer fillimisht në Ballsh në Zejmen. Në vitin 1985, dërgohet në burgun famëkeq të Burrelit, ku qëndron deri sa lirohet si rezultat i amnistisë së 29 nëntorit 1989.

Në Burgun e Burrelit, Edip Ohri ishte me kategorinë e “armiqve të partisë dhe të pushtetit”: gjenerallejtënant, Heroi i Popullit, Rahman Parllaku; gjenerallejtënant dhe Hero i Popullit, Muhamet Prodani; gjenerallejtënant dhe Heroi i Popullit, Sadik Bekteshi; gjenerallejtënant Arif Hasko; gjenerallejtënant Vaskë Gjino; gjeneralmajor Gjin Marku; gjeneralmajor Abaz Fejzo; gjeneralmajor Halim Ramohito; gjenerallejtënant Mihallq Ziçishti, ministër i Tregtisë së Brendshme dhe të Jashtme, Kiço Ngjela; ministër i Bujqësisë Maqo Como ministër i Jashtëm Nesti Nase; Fadil Paçrami sekretar i Komitetit të Partisë për Tiranën; Todi Lubonja kryeredaktor i “Zërit të Popullit” dhe drejtor i Televizionit Shqiptar; Gjergj Titani, ish-shef i Shtabit të Korpusit; Spartak Ngjela e Fatos Lubonja; Lipe Nashi, drejtor i Përgjithshëm i Naftës; Xhavid Qesja, ish-komisar i Br XXII S; Bardhyl Belishova; Skënder dhe Bashkim Shehu; kolonel Elhami Hado, nënkolonel Shaban Reçi etj.


Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të padrejtë, në burgun e Burrelit është i njohur dhe për pathyeshmërinë e treguar. Ai kishte cilësi të larta njerëzore, ndershmëri, sinqeritet, mirënjohje ndaj të tjerëve, përkushtim të patundur ndaj Atdheut.

“DEKORATA E ARTË E SHQIPONJËS” PËR EDIP OHRIN

Me merita të veçanta drejtuese, profesionalizëm të lartë, vizion e perspektivë, Edip Ohri luajti rolin vendimtar si strateg i aviacionit në krijimin e zhvillimit të kësaj arme, që nga krijimi i Repartit të Parë të Aviacionit në Laprakë e më pas regjimentet luftarake të Rinasit, Kuçovës, Farkës, Shkollës së Aviacionit, Uzinës së Aviacionit e deri Regjimenti i Gjadrit, duke pajisur Shqipërinë me 200 aeroplanë. Gjatë karrierës së tij ushtarake, si pilot i Aviacionit të Shqipërisë, ka fluturua me avionët e parë P-2, P-9, Jak-16, helikopterët Mi-1, Mi-4, Il-14, Il-28 në Mig-ët 15,17,19,21. Aviacioni shqiptar, deri në vitet 1980 mund të konsiderohej i barabartë me fqinjët në teknikë e eksploitim, sepse ai kishte një uzinë moderne, punonte me karburantin e prodhuar në vend, kishte një shkollë aviacioni bashkëkohore, infrastrukturë e aerodrome të standardeve të larta, vendkomandë qendrore moderne e mbështetur me mjete navigimi e drejtimi modern, (deri radarë PLL-35 për drejtimin e Aviacionit Luftarak), helikopterë, aeroplanë të transportit AN-2, Il14, si për fluturimet në kondita të thjeshta meteorologjike, të vështira, natën, por edhe të raketave moderne tokë-ajër SAM-2 dhe artilerisë së shumtë kundërajrore.

Gjeneral Rrahman Parllaku – “Hero i Popullit dhe Nderi i kombit”, në vlerësim të figurës së Edip Ohrit është shprehur se: “Shteti shqiptar duhet t'i jetë mirënjohës pafundësisht Edip Ohrit për largpamësinë dhe organizimin që tregoi si Komandant i Aviacionit Luftarak, duke planifikuar, organizuar, realizuar dhe tërhequr në kohë ndihmat kineze për motorë e pjesë këmbimi për avionë, në atë masë, saqë ky aviacion nuk pati nevojë të harxhonte asnjë dollar, rubla apo valutë edhe për 30 vite të tjera, pas largimit të tij nga detyra. Si sekretar i përgjithshëm i OBVL-së, Edip Ohri, për 15 vite ka dhënë një kontribut të shquar për organizimin dhe konsolidimin e strukturave të kësaj organizate”.

Pikërisht për këtë emër e kontribut të vyer, ish-Presidenti i RSH-së, Bujar Nishani, i ka akorduar Edip Ohrit “Dekoratën e Artë të Shqiponjës”.





Dita e Evropës 2026 në Paris: Muzika bashkoi kulturat europiane në sheshin "Republika"

"Big Band" OSFA përfaqëson Shqipërinë në një mbrëmje europiane kulture dhe muzike

Më 9 maj 2026, kryeqyteti francez u kthye në epiqendrën e festimeve europiane, ndërsa sheshi historik "Place de la République" në Paris mirëpriti mijëra qytetarë në kuadër të Ditës së Evropës. Aktiviteti, i organizuar nga Bashkia e Parisit në bashkëpunim me përfaqësuesit francez të Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, u konceptua si një manifestim qytetar dhe kulturor kushtuar unitetit, diversitetit dhe vlerave europiane.

Përgjatë gjithë ditës, sheshi u shndërrua në një hapësirë të hapur dialogu dhe ndërveprimi, ku qytetarë të gjitha moshave morën pjesë në aktivitete kulturore, debate publike, forume informuese dhe prezantime të institucioneve europiane. Në qendër të diskutimeve ishin sfidat aktuale të kontinentit, që nga siguria dhe gjeopolitika, deri te investimet dhe perspektiva e bashkëpunimit evropian.

Në këtë atmosferë simbolike, morën pjesë ambasadorë, eurodeputetë, përfaqësues diplomatikë dhe autoritete franceze, mes tyre edhe Kryetari i Bashkisë së Parisit, Emmanuel Grégoire, të cilët riafirmuan rëndësinë e projektit evropian dhe rolin e kulturës si urë bashkimi ndërmjet popujve.

Në mbrëmje, fokusi i aktivitetit kaloi tek muzika, e konsideruar si gjuha universale që kapërcen kufijtë politikë dhe kulturorë. Për organizimin artistik, Bashkia e Parisit rinovoi bashkëpunimin me festivalin e njohur evropian "Europavox", i cili prej vitit 2006 promovon artistë dhe talente të reja nga vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Në edicionin e këtij viti, skena e ngritur në zemër të Parisit mirëpriti artistë nga Shqipëria, Moldavia, Ukraina dhe Franca, duke krijuar një atmosferë të jashtëzakonshme bashkimi kulturor.

"Big Band" OSFA, prezantim dinjitoz i Shqipërisë në Paris

Një nga momentet më të veçanta të mbrëmjes ishte performanca e "Big Band" OSFA, formacionit muzikor të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili përfaqësoi vendin tonë në këtë aktivitet prestigjioz evropian.

E ardhur nga Tirana, trupa shqiptare solli në Paris një ndërthurje të veçantë të traditës muzikore shqiptare me elementë modernë rock dhe jazz, duke fituar menjëherë vëmendjen dhe duartrokitjet e publikut ndërkombëtar.

"Big Band" OSFA, pjesë e strukturave artistike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, përfaqëson një nga institucionet më serioze muzikore ushtarake në Shqipëri dhe ndjek traditën e orkestrave prestigjioze europiane të forcave të armatosura.

Nën drejtimin e dirigjentit dhe drejtorit të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, Arben Skënderi, artistët shqiptarë interpretuan disa nga standardet më të njohura të repertorit kombëtar në një frymë moderne dhe energjike.

Interpretimi vokal i Petro Fejzës dhe performanca virtuozë e kitaristit të njohur Bledar Sejko krijuan një kombinim artistik që u prit me shumë entuziazëm nga publiku francez dhe ndërkombëtar.

Bledar Sejko, pionier i rock-ut shqiptar

Prania e Bledar Sejkos në këtë koncert përbente një vlerë të shtuar artistike. I konsideruar si një nga figurat më të rëndësishme të muzikës rock në Shqipëri, Sejko është ndër pionierët e këtij zhanri që prej viteve '80, në një kohë kur muzika rock konsiderohej frymë kundërshtuese ndaj



izolimit kulturor të regjimit komunist.

Në vitet '90 ai u bë pjesë e grupeve të njohura metal shqiptare si "Megahertz" dhe "Thunder Way", ndërsa në vitin 2013 përfaqësoi Shqipërinë në Festivalin Evropian të Këngës "Eurovision", së bashku me Adrian Lulgjurajn, me këngën "Identitet".

Përmes eksperiencës dhe profesionalizmit të tij, Sejko solli në skenën pariziene një interpretim dinamik dhe modern të muzikës shqiptare, duke promovuar identitetin kulturor kombëtar në një aktivitet me përmasa europiane.

Diplomacia kulturore shqiptare në qendër të Parisit

"Big Band" OSFA njihet për pjesëmarrjen e tij në aktivitete shtetërore, ceremoni ushtarake, vizita zyrtare dhe ngjarje të rëndësishme kulturore brenda dhe jashtë vendit. Formacioni ka përfaqësuar Shqipërinë në shumë skena

ndërkombëtare, duke kontribuar në promovimin e kulturës shqiptare dhe imazhit të Forcave të Armatosura.

Në koncert ishte i pranishëm edhe Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Francë, Sh. T. z. Dritan Tola, i cili ndoqi nga afër performancën e artistëve shqiptarë dhe mbështeti këtë prezantim kulturor të Shqipërisë në zemër të Evropës.

Pjesëmarrja e "Big Band" OSFA në Ditën e Evropës në Paris përbën një tjetër dëshmi të rolit që arti dhe kultura luajnë në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë kulturore shqiptare.

Muzika si simbol i unitetit evropian

Përveç performancës shqiptare, publiku pati mundësinë të ndjekë edhe interpretimet e artistes moldave Valeria Stoica, artistit ukrainas Postman dhe këngëtares franceze Solann, fituese e çmimit "Révélation Féminine" në "Victoires de la Musique 2025".

Në fund të mbrëmjes, atmosfera në sheshin "Republika" u shndërrua në një festë të madhe europiane, ku muzika bashkoi kultura, gjuhë dhe identitete të ndryshme.

Dita e Evropës 2026 në Paris dëshmoi edhe një herë se kultura mbetet një nga elementët më të fuqishëm të afrimit ndërmjet popujve dhe një instrument i rëndësishëm për promovimin e dialogut, paqes dhe mirëkuptimit ndërkombëtar.



CARAFFA NDERON GJENNARO MICELI-n

Arbëreshi që bashkoi idealin politik, dijen dhe shpirtin e popullit



Doc. Dr. ELIDIANA CANAJ

Një figurë e madhe arbëreshe rikthehet në kujtesën historike të Kalabrisë dhe shqiptarëve

Më 9 maj, mikesha ime arbëreshe, "Ambasadore e Kombit", e palodhura dhe e përkushtuara Cettina Mazzei, më dërgoi këtë material të shkruar mbi një figurë të shquar arbëreshe, që do të përkujtohet me dashuri dhe mirënjohje nga komuniteti arbëresh në bashkinë e Caraffa di Catanzaro, në një ceremoni të mirë organizuar.

Edhe komuniteti i shqiptarëve në Shqipëri i vlerëson thellë arbëreshët për shumë arsye etnike, ekzistenciale, historike, por edhe aktuale. Vlerëson genin dhe angazhimet e tyre aktive arbërore, krenarinë dhe vullnetin për të mbajtur gjallë vlerat etnike arbërore, dëshirën gjenetike për të ruajtur kontaktet dhe komunikimin me dheun amë të paraardhësve të tyre, Shqipërinë.

I vlerësojmë si pasqyrën e historisë së të parëve, si pasqyrën e vitalitetit dhe mbijetesës së kulturës arbëreshe dhe shqiptare në një komunitet të ndryshëm nga ai identitar etnik dhe shtetëror, edhe pse juridikisht dhe faktikisht mbeten pjesë e tij.

Krenohemi për modelin që arbëreshët janë!

Krenohemi për dëshminë e gjallë të përshtatjes, integritetit dhe ruajtjes së vlerave kulturore etnike identitare që arbëreshët përfaqësojnë!

Ndonëse mbetet ende shumë për të bërë. Institucionet duhet të jenë edhe më të angazhuara në harmonizimin e zgjidhjeve të domosdoshme sipas nevojave dhe realiteteve që arbëreshët jetojnë e kërkojnë, në mënyrë që trashëgimia të mos mbetet vetëm praktike dhe familjare.

Dëshmitë provojnë praktikisht dhe realisht se ne shqiptarët e vjetër dhe të rinj nuk jemi pak.

Lavdi punës dhe përpjekjeve titanike atdhetare të arbëreshëve, pjesa e gjakut historik të shqiptarësisë!

Lavdi Gennaro Miceli!

Lavdi organizatorëve dhe pjesëmarrësve nderues e mirënjohës të kujtimit dhe vlerave!

NGA BRUNO GEMELLI

Caraffa rizbulon Gennaro Miceli-n: Komunistin që bashkoi ekspertizën teknike, vizionin politik dhe rrënjët popullore

Një muze kushtuar inxhinierit dhe ish-zëvendësitor parlamentar Gennaro Miceli protagonist i heshtur në historinë e Partito Comunista Italiano dhe zë autoritar i Jugut të harruar, do të hapet në fshatin arbëresh të Caraffa di Catanzaro.

Komuna e Caraffa-s, një qytet me më pak se dy mijë banorë që flasin arbërisht dhe jetojnë ende në traditën arbëreshe, pak kilometra larg kryeqytetit rajonal, ka përfunduar idenë e krijimit të një muzeu për qytetarin e saj më të shquar, ish-deputetin komunist Gennaro Miceli, i cili u nda nga jeta në vitin 1976, në moshën 75-vjeçare.

Miceli ishte një figurë e rëndësishme në botën komuniste italiane të kohës, siç dëshmojnë shumë figura të politikës kombëtare italiane.

Komuna e Caraffa-s arriti ta realizojë këtë projekt falë vendimit të djalit të tij, Alessandro Miceli, i cili jeton në Romë dhe ka punuar më parë për studion filmike "De Laurentiis". Ai do t'ia dhurojë shtëpinë stërgjyshore komunës, e cila do të shndërrohet në muze memorial.

Kush ishte Gennaro Miceli?

Gennaro Miceli ishte një nga figurat më të rëndësishme historike të politikës së Catanzaro-s dhe një udhëheqës me ndikim i Partisë Komuniste Italiane.

Ai ishte: një intelektual i shkëlqyer, një teknik shumë i aftë, një inxhinier me kulturë të thellë shkencore, një politikan i respektuar i Italisë Jugore, dhe mbi të gjitha, një mik i punëtorëve.

Figura e tij u bë qendrore në politikën kalabreze dhe kombëtare në vitet rreth Luftës së Dytë Botërore.

Ai fitoi jo vetëm dashurinë e proletariatit kalabrez që vërshonte nga larg për ta dëgjuar, por edhe respektin e figurave të mëdha të udhëheqjes komuniste italiane: Palmiro Togliatti, Umberto Terracini, Giorgio Amendola, Alessandro Natta, Paolo Bufalini, Emanuele Macaluso e shumë të tjerë.

Ekonomisti Napoleone Colajanni do të shprehej: "Gennaro Miceli ishte mentori im".

Edhe Presidenti italian Giorgio Napolitano e vlerësonte jashtëzakonisht shumë.

Në vitin 1963, Partia e emëroi nënkryetar të grupit parlamentar në Dhomën e Deputetëve, ndërkohë që presidenca mbahej nga vetë Togliatti.

Universiteti në Napoli dhe kthimi në Kalabri

Gennaro Miceli lindi më 13 tetor 1901 në Caraffa di Catanzaro, një enklavë arbëreshe pranë Catanzaros, nga Alessandro Miceli dhe Teresina Cilberti.

Ai pati dy fëmijë: Alessandro Miceli, dhe Wanda Teresa Miceli, piktoreshe e talentuar që u nda herët nga jeta.

Pasi përfundoi studimet në Catanzaro, në moshën 17-vjeçare u regjistrua në Universitetin Politeknik të Napolit, ku u diplomua për inxhinieri industriale vetëm 20 vjeç.

Në Napoli ai u njoh me: Amedeo Bordiga, u përfshi në lëvizjen socialiste dhe më pas në Partinë Socialiste Italiane. Pas ndarjes së Livornos në vitin 1921, ai iu bashkua Partisë Komuniste Italiane, duke organizuar klubet e para rinore në zonën e Napolit.

Përballja me fashizmin

Pas diplomimit në vitin 1923, Miceli u kthye në Kalabri dhe u bë organizator aktiv i partisë në provincën e tij.

Në moshë të re fitoi titullin profesor i Teknologjisë Mekanike në Institutin Teknik "Ercolino Scalfaro" në Catanzaro.



Por regjimi fashist ia hoqi këtë titull në vitin 1925 për shkak të bindjeve të tij politike.

Gjatë periudhës fashiste ai u përfshi në veprimtari klandestine dhe u arrestua disa herë nga policia sekrete fashiste, OVRA.

Profesioni dhe vetëmohimi

Për të siguruar jetesën, ai ushtroi profesionin privat të inxhinierit.

Megjithëse mbahej vazhdimisht nën vëzhgim si "antifashist i rrezikshëm", njohuritë e tij shkencore ishin shumë të kërkuara.

Studimet e tij mbi digat e Silas, dhe sistemet e bonifikimit të tokës, u konsideruan ndër më të rëndësishmet e kohës.

Nga viti 1948 deri në vitin 1972 ai qëndroi pa ndërprerje në Montecitorio, i zgjedhur nga votuesit kalabrezë.

Një teknik i kalibrit të tij mund të kishte fituar pasuri të mëdha, por ai zgjodhi t'i përkushtohej kauzës politike dhe shoqërore.

Ai u bë simbol i vetëmohimit, humanizmit, oratorisë së fuqishme, dhe lidhjes me shtresat e varfra.



Zëri i Jugut dhe "babai" i kooperativave të kuqe

Në vitin 1943 ai riorganizoi Partinë në provincën e Catanzaros dhe nga 1944 deri në 1948 drejtoi federatën komuniste lokale. Ai ishte ndër të parët në Itali që kuptoi rëndësinë e kooperativave në ekonominë prodhuese.

Në vitin 1950 u bë president i ANCA-s. Miceli konsiderohet nga shumë studiues si "babai i kooperativave të kuqe" në Itali.

Një parlamentar që mbushte sallën

Në Parlament ai fitoi reputacion si një politikan që fliste vetëm për çështje që i njihte në thellësi.

Palmiro Togliatti e vlerësonte aq shumë, sa shpesh i kërkonte mendime përmes shënimeve personale të shkruara me bojë të gjelbër.

Kur shpërtheu skandali i Federconsorzi-t dhe Trabucchi-t, ishte pikërisht Miceli ai që trajtoi çështjen në emër të Partisë. Thuhej se: "Kur Gennaro Miceli fillonte të fliste, salla e Montecitorios mbushej menjëherë".

Kujtesa e Chiaromonte-s

Gerardo Chiaromonte, gjatë ceremonisë së zbulimit të bustit të Micelit në vitin 1980, deklaroi: "E mbaj mend Micelin në Romë, kur ishte nënkryetar i grupit të deputetëve komunistë. Më kujtohet ndihma, mirëkuptimi dhe miqësia me të cilën më nderoi. Ai ishte një orator i madh parlamentar."

Një kujtesë që nuk duhet të shuhet

Gennaro Miceli u nda nga jeta në Romë, më 9 korrik 1976. Në përvjetorin e 50-të të ndarjes së tij nga jeta, komuniteti arbëresh i Caraffa-s e rikthen në qendër të kujtesës historike.

Në një kohë kur kujtesa historike shpesh zbehet, arbëreshët vazhdojnë të dëshmojnë se identiteti, kultura dhe rrënjët nuk ruhen vetëm me fjalë, por me përkushtim brez pas brezi.

Dhe emri i Gennaro Miceli-t mbetet një simbol i rrallë i dijes, integritetit, politikës me ideal dhe krenarisë arbëreshe.

Rrugëtimi i Gjaket dhe Besës: Kujtim për të Rënët e Pasluftës



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Periodha menjëherë pas çlirimit të Shqipërisë, në nëntor 1944, u karakterizua nga përpjekje të shumanshme për konsolidimin e rendit të ri politik, ekonomik dhe shoqëror. Në këtë kontekst, krahas rindërtimit të vendit dhe organizimit të institucioneve shtetërore, një sfidë e rëndësishme mbeti neutralizimi i grupeve të armatosura, të cilat në dokumentacionin e kohës cilësohen si “banda diversante” apo “formacione reaksionare”.

Qarku i Shkodrës dhe zonat përreth, përfshirë Malësinë e Madhe dhe Mirditën, përbënin një nga hapësirat më të ndjeshme në këtë drejtim, për shkak të traditës së armatosjes, strukturave fisnore dhe ndikimeve të ndryshme politike.

Në këtë kapitull paraqiten disa prej figurave që humbën jetën gjatë përballjeve me këto grupe, duke u konsideruar nga historiografia e periudhës si dëshmorë të mbrojtjes së pushtetit popullor.

Figura dhe raste të veçuara

Gjon Pjetër Mjeku (1924-1945)

(Karnë, Shkodër)

Gjon Pjetër Mjeku lindi në një familje me tradita të spikatura shoqërore dhe atdhetare. I ati, Pjetër Mjeku, përmendet në burimet gojore si figurë me ndikim në komunitet, i njohur për ndihmën ndaj luftëtarëve në fillim të shekullit XX.

Pas çlirimit, Gjoni u përfshi në strukturat e reja të pushtetit vendor, duke u zgjedhur anëtar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në një moshë relativisht të re. Krahas kësaj, ai vijoi edhe traditën familjare si mjek popullor.

Më 12 shkurt 1945, gjatë një lëvizjeje për detyra institucionale, ai u vra në një pritë të organizuar nga një grup i armatosur.

Përballja me bandat e armatosura në Shqipërinë e pasçlirimit (1945-1949)

Jak Gjon Nikolla (1905-1945)

(Gomsiqe, Shkodër)

Jak Gjon Nikolla iu bashkua forcave partizane në fazën përfundimtare të Luftës Nacionalçlirimtare, në nëntor 1944. Pas çlirimit, ai u angazhua në operacionet e ndjekjes së grupeve të armatosura në zonën e Gomsiqes.

Sipas të dhënave lokale, ai u vra në prill 1945 në zonën e Qafës së Gurit, gjatë një përlëshjeje të drejtpërdrejtë me këto formacione.

Jonuz Naç Çulaj (1895-1945)

(Koplik, Shkodër)

Figura e Jonuz Naç Çulajt paraqet vazhdimësinë e angazhimit të brezave në lëvizjet kombëtare. Ai kishte marrë pjesë në Kryengritjen e Malësisë së Madhe (1911), në Luftën e Koplikut (1920) dhe në zhvillimet politike të vitit 1924.

Në periudhën pas-çlirimtare, ai mbante funksionin e komandantit të vendit në zonën Bajzë-Kastrat, duke drejtuar operacionet e patrullimit dhe kontrollit territorial.

Ai u vra në një përplasje të armatosur me banda lokale në vitin 1945, së bashku me një pjesë të bashkëluftëtarëve të tij. Figura e tij është ruajtur në kujtesën kolektive edhe përmes krijimtarisë gojore.

Kolë Gjon Marashi (1926-1945)

(Brashtë, Shkodër)

Kolë Marashi u përfshi herët në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, fillimisht në njësitet guerile dhe më pas në formacionet partizane, konkretisht në batalionin “Perlat Rexhepi”.

Pas çlirimit, ai u angazhua në strukturat ushtarako-administrative të zonës së Dukagjinit. Ai humbi jetën më 3 qershor 1945, në rrethana që lidhen me përpjekjet për stabilizimin e rendit të ri shtetëror.

Myftar Sokol Zeneli (1920-1945)

(Reç, Shkodër)

Myftar Zeneli ishte pjesëmarrës aktiv në luftën kundër pushtuesve italianë dhe më pas në strukturat e mbrojtjes vendore. Më 19 janar 1945, gjatë një sulmi të një grupi të armatosur ndaj komandës së vendit, ai u vra duke mbrojtur pozicionin e tij.

Rasti i familjes Prenga (Lala): Një traditë e qëndrueshme

Konteksti familjar dhe historik

Familja e Frrok Preng Lalës nga Mnelë përfaqëson një rast të veçantë të angazhimit të vazhdueshëm në lëvizjet e armatosura dhe politike të kohës.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, shtëpia e tyre shërbeu si bazë për veprimtarinë ilegale dhe për strehimin e partizanëve.

Pas çlirimit, pjesëtarët e kësaj familjeje vijuan aktivitetin në strukturat e pushtetit vendor dhe në operacionet kundër grupeve të armatosura.

Dodë Frrok Prenga (1917-1946)

Si drejtues i këshillit popullor të fshatit, Dodë Prenga u angazhua në organizimin e jetës arsimore dhe ekonomike.

Ai u vra në qershor 1946 gjatë një operacioni ndjekjeje ndaj një bande të armatosur në zonën e Mnelës.

Pjetër Frrok Prenga (1914-1947)

Pjetër Prenga ishte një figurë aktive në operacionet kundër bandave në zonat malore të veriut. Ai humbi jetën më 26 dhjetor 1947 gjatë një përlëshjeje në zonën e Kashnjetit.

Preng Frrok Prenga (1906-1949)

Si vëllai më i madh, Preng Prenga kishte një rol të rëndësishëm në koordinimin e aktivitetit lokal. Ai u vra në vitin 1949 në një pritë të organizuar nga kundërshtarët e armatosur.

Përfundime

Rastet e paraqitura në këtë shkrim dëshmojnë për kompleksitetin e periudhës së pasçlirimit në Shqipëri, ku përpjekjet për ndërtimin e një rendi të ri u shoqëruan me konflikte të armatosura në disa zona të vendit.


Figura të tilla si Gjon Mjeku, Jonuz Çulaj apo pjesëtarët e familjes Prenga përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të narrativës historike të kësaj periudhe, duke u trajtuar në historiografinë zyrtare si dëshmorë të konsolidimit të shtetit.



RANË NË PËRBALLJE ME BANDAT QË SYNONIN RRËZIMIN E PUSHTETIT POPULLOR




Jak Gjon Nikolla



Jonuz Naç Çulaj



Dodë Frrok Prenga



Pjetër Frrok Prenga



Kolë Gjon Marashi



Myftar Sokol Zeneli



Preng Frrok Prenga



Gjon Pjetër Mjeku

Krahas
rindërtimit
të vendit

dhe organizimit
të institucioneve
shtetërore, një
sfidë e rëndësishme
mbeti neutralizimi
i grupeve të
armatosura, të cilat
në dokumentacionin
e kohës cilësohen si
“banda diversante”
apo “formacione
reaksionare”.

Në epokën e teknologjisë digjitale, ku inteligjenca artificiale po shndërrohet në motorin kryesor të inovacionit, ekziston një element shpesh i padukshëm, por jetik: mineralet kritike. Pa to, kompjuterët me shpejtësi të lartë, qendrat e të dhënave dhe sistemet e avancuara nuk do të funksiononin me stabilitetin që njohim sot. Këto materiale janë baza e çdo algoritmi, çdo çipi dhe çdo pajisjeje që përdorim për të komunikuar, për të mësuar apo për të krijuar.

Një shembull i qartë është palladiumi. Ky metal i çmuar përdoret për të rregulluar tensionin elektrik brenda mikroçipave, duke parandaluar shpërthimet e energjisë dhe duke ruajtur ekuilibrin delikat të qarqeve. Pa të, balanca elektrike e kompjuterëve modernë do të ishte shumë më e vështirë për t'u mbajtur, duke rrezikuar prishje të vazhdueshme. Por palladiumi është vetëm një pjesë e mozaikut. Silici, i njohur si “zemra e teknologjisë”, është materiali bazë i gjysmëpërçuesve, ndërsa galliumi dhe germaniumi përdoren për çipa të avancuar dhe fibra optike që lidhin qendrat e të dhënave në mbarë botën.

Në fushën e memories dhe pajisjeve logjike, kobalti ka një rol të pazëvendësueshëm. Ai rrit performancën e pajisjeve të memories, duke i bërë më të shpejta dhe më të qëndrueshme. Nikel dhe bakri sigurojnë përçueshmëri të lartë, ndërsa elementë si ruteniumi dhe indiumi kontribuojnë në stabilitetin e qarqeve. Pa këto materiale, kompjuterët nuk do të ishin në gjendje të ruanin dhe të përpunonin sasi të mëdha të dhënash me shpejtësinë që kërkon inteligjenca artificiale.

Një tjetër grup i rëndësishëm janë elementët e rrallë të tokës. Neodimiumi, praseodimiumi, samariumi, terbiumi dhe disprosiumi përdoren për të krijuar magnetë të fuqishëm, të cilët gjenden në motorët e pajisjeve të avancuara dhe në sistemet e robotikës. Pa këta magnetë, shumë prej teknologjive që sot marrim si të mirëqena nuk do të ekzistonin. Ndërkohë, europiumi dhe gadoliniumi kanë rol të veçantë në ekranet dhe pajisjet optike, duke mundësuar cilësi të lartë të imazhit.

Energjia është një tjetër fushë ku mineralet kritike janë të domosdoshme. Litiumi është baza e baterive që fuqizojnë pajisjet mobile dhe qendrat e të dhënave. Grafiti dhe mangani përdoren për anodë dhe katodë, ndërsa platina dhe ari sigurojnë kontakte elektrike të qëndrueshme. Pa këto materiale, ruajtja e energjisë do të ishte shumë më e vështirë, duke penguar zhvillimin e teknologjive të reja.

Megjithatë, pas gjithë këtij progresi fshihen edhe sfida të mëdha. Shumë vende janë të varura nga importet për këto minerale, duke krijuar rreziqe strategjike. Kina kontrollon pjesën më të madhe të prodhimit dhe rafinimit të disa elementëve kyç, si galliumi dhe germaniumi, duke e bërë zinxhirin e furnizimit të pasigurt. Përveç kësaj, nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve shpesh lidhen me dëme mjedisore dhe shkelje të të drejtave të njeriut, duke ngritur pyetje mbi etikën e zhvillimit teknologjik.


Në përfundim, mineralet kritike janë “nafta e re” e shekullit XXI. Pa to, inteligjenca artificiale, qendrat e të dhënave dhe teknologjitë digjitale nuk do të ekzistonin në formën që njohim sot. Sfida kryesore mbetet sigurimi i zinxhirëve të furnizimit të qëndrueshëm dhe etik, ndërsa kërkesa për AI po rritet me ritme të papara. Nëse bota nuk arrin të menaxhojë me kujdes këto burime, rrezikon që progresi teknologjik të ngadalësohet ndjeshëm dhe të krijohen tensione të reja gjeopolitike.

Palladiumi – mbrojtësi i çipave

Një nga mineralet më të rëndësishme është palladiumi. Ky metal i çmuar ndihmon në rregullimin e tensionit elektrik brenda kompjuterëve me shpejtësi të lartë, duke parandaluar shpërthimet e energjisë. Pa të, balanca delikate e elektricitetit në mikroçipa do të ishte shumë më e vështirë për t'u mbajtur, duke rrezikuar prishje të vazhdueshme dhe humbje të të dhënave.

Silici dhe gjysmëpërçuesit

Silici është zemra e teknologjisë moderne. Ai është materiali bazë i gjysmëpërçuesve, pa të cilët nuk do të ekzistonin mikroprocesorët, telefonat inteligjentë apo serverët që mbajnë gjallë inteligjencën artificiale. Në kombinim me elementë si galliumi dhe germaniumi, silici mundëson prodhimin e çipave



Një nga mineralet më të rëndësishme është palladiumi. Ky metal i çmuar ndihmon në rregullimin e tensionit elektrik brenda kompjuterëve me shpejtësi të lartë, duke parandaluar shpërthimet e energjisë. Pa të, balanca delikate e elektricitetit në mikroçipa do të ishte shumë më e vështirë për t'u mbajtur, duke rrezikuar prishje të vazhdueshme dhe humbje të të dhënave.

të avancuar dhe fibrate optike që lidhin qendrat e të dhënave në mbarë botën.

Kobalti dhe energjia e memories

Në fushën e memories dhe pajisjeve logjike, kobalti ka një rol të pazëvendësueshëm. Ai rrit performancën e pajisjeve të memories, duke i bërë më të shpejta dhe më të qëndrueshme. Pa këtë mineral, kompjuterët nuk do të ishin në gjendje të përpunonin sasi të mëdha të dhënash me shpejtësinë që kërkon inteligjenca artificiale.

Elementët e rrallë të tokës

Një tjetër grup i rëndësishëm janë elementët e rrallë të tokës. Neodimiumi, praseodimiumi, samariumi, terbiumi dhe disprosiumi përdoren për të krijuar magnetë të fuqishëm, të cilët gjenden në motorët e pajisjeve të avancuara dhe në sistemet e robotikës. Pa këta magnetë, shumë prej teknologjive që sot marrim si të mirëqena nuk do të ekzistonin. Ndërkohë, europiumi dhe gadoliniumi kanë rol të veçantë në ekranet dhe pajisjet optike, duke mundësuar cilësi të lartë të imazhit.

Litiumi dhe bateritë

Energjia është një tjetër fushë ku mineralet kritike janë

të domosdoshme. Litiumi është baza e baterive që fuqizojnë pajisjet mobile dhe qendrat e të dhënave. Pa të, ruajtja e energjisë do të ishte shumë më e vështirë, duke penguar zhvillimin e teknologjive të reja.

Sfida globale

Megjithatë, pas gjithë këtij progresi fshihen edhe sfida të mëdha. Shumë vende janë të varura nga importet për këto minerale, duke krijuar rreziqe strategjike. Kina kontrollon pjesën më të madhe të prodhimit dhe rafinimit të disa elementëve kyç, si galliumi dhe germaniumi, duke e bërë zinxhirin e furnizimit të pasigurt. Përveç kësaj, nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve shpesh lidhen me dëme mjedisore dhe shkelje të të drejtave të njeriut, duke ngritur pyetje mbi etikën e zhvillimit teknologjik.

Mineralet kritike janë “nafta e re” e shekullit XXI. Pa to, inteligjenca artificiale, qendrat e të dhënave dhe teknologjitë digjitale nuk do të ekzistonin në formën që njohim sot. Sfida kryesore mbetet sigurimi i zinxhirëve të furnizimit të qëndrueshëm dhe etik, ndërsa kërkesa për AI po rritet me ritme të papara. Nëse bota nuk arrin të menaxhojë me kujdes këto burime, rrezikon që progresi teknologjik të ngadalësohet ndjeshëm dhe të krijohen tensione të reja gjeopolitike.



Qendra e Personel Rekrutimit *hap aplikimet për* “Kursin e Përgatitjes së Oficerit për Pilot”

Qendra e Personel Rekrutimit ka hapur aplikimet për “Kursin e Përgatitjes së Oficerit për Pilot”, një program i dedikuar për të rinjtë që synojnë të ndërtojnë karrierë në Forcën Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe të kontribuojnë në shërbim të vendit.

Ky kurs do të zhvillohet në periudhën shtator 2026 – korrik 2028, duke ofruar një formim të plotë profesional, teorik dhe praktik, për përgatitjen e oficerëve pilotë në përputhje me standardet bashkëkohore të aviacionit ushtarak.

Në total janë të hapura 10 kuota, të cilat u ofrohen kandidatëve të rinj të motivuar, të cilët plotësojnë kriteret dhe dëshirojnë të ndjekin një karrierë sfiduese dhe dinjitoze në Forcat e Armatosura.

Ky program synon të përgatisë kuadro të rinj të aftë profesionalisht, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të Forcës Ajrore dhe modernizimin e strukturave të saj.
Informacione dhe kontakt

Për më shumë informacion mbi kriteret e aplikimit dhe procedurat përkatëse, të interesuarit mund të kontaktojnë:

Tel: **00355 4 234 8588**

WhatsApp: **+355 68 340 4896**

Aplikimi online

Detajet e plota dhe informacioni zyrtar gjenden në faqen e Ministrisë së Mbrojtjes:

<https://www.mod.gov.al/newsroom/njoftime/studente-brenda-jashte-vendit>

Qendra e Personel Rekrutimit fton të gjithë të rinjtë e apasionuar pas aviacionit ushtarak që të aplikojnë dhe të bëhen pjesë e një prej karrierave më prestigjioze në Forcat e Armatosura.